ExLibris

E PËRJAVSHME LETRARE & KULTURORE

Themelues BUJAR HUDHRI
Kryeredaktore VIOLETA MURATI

E SHTUNË, 19 TETOR 2019. NUMËR 49. VITI I I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

"Çmimi Nobel është sërish çmimi më i njohur, dhe askush nuk mund të konkurrojë me një institucion kaq të nderuar, megjithatë çmimi ynë është një lloj alternative ndaj Nobel-it. Ne asnjëherë nuk marrim parasysh arsye gjeografike, ideologjike apo politike. Çmimi ynë jepet rreptësisht vetëm për arritje letrare".

—Ivar Ivask

VITI I SUKSESIT NDËRKOMBËTAR TË SHKRIMTARIT TONË TË SHQUAR

KADARE NDEROHET NË AMERIKË

ME ÇMIMIN E FAMSHËM "NEUSTADT INTERNATIONAL 2020" I QUAJTUR

"THE AMERICAN NOBEL PRIZE"

DITËN E HËNË KADARE NISET PËR NË SEUL PËR TË MARRË ÇMIMIN E RËNDËSISHËM "PARK KYONG-NI"

RUDOLF MARKU: Të shkruash pa pasur lexues, është si të vallëzosh në errësirë

Intervistoi: Violeta Murati

Portreti nga Ina Lajthia

MUNGESA E STENDËS "ALBANIA" NË PANAIRIN E LIBRIT NË FRANKFURT DHE TETORI I LIBRIT NË TIRANË

nga Bujar Hudhri

Një tubim i rëndësishëm shkencor albanologjik në Universitetin e Zarës

nga Evalda PACI

Ndahet nga jeta kritiku i mirënjohur amerikan

Harold Bloom: Si dhe përse të lexojmë



Teki Dervishi, një shkollë e nxënë jashtë librave

Nga Emin AZEMI

EDITH SÖDERGRAN, VAJZA QË ÇLIROI POEZINË

nga Shqiptar Oseku

ATWOOD DHE EVARISTO FITUESE TË "THE BOOKER PRIZE 2019"

The Booker Prize 2019

KADARE, FITUES I ÇMIMIT PRESTIGJIOZ NEUSTADT

World Literature Today, revista ndërkombëtare e letërsisë dhe kulturës, shpalli në orët e vona të mbrëmjes së të mërkurës që Ismail Kadare është fituesi i 26-të i Çmimit të famshëm Ndërkombëtar Neustadt në Letërsi. I dhënë çdo dy vjet, Çmimi Neustadt ka meritë letrarë të jashtëzakonshme në letërsinë mbarëbotërore.

Robert Con Davis-Undiano, drejtori ekzekutiv i *World Literature Today*, thotë se Kadare është "një nga shkrimtarët më të mëdhenj të botës dhe një mbrojtës i demokracisë dhe fjalës së lirë".

Çmimi Neustadt, shpesh referohet si "Nobel-i Amerikan" për reputacionin e tij si pasrendës i përzgjedhjes vjetore të Akademisë së Suedisë. Çdo shkrimtar i gjallë nga kudo në botë është i pranueshëm për këtë çmim. Juria është e përbërë nga autorë të mirënjohur ndërkombëtarë, dhe ky fakt ndihmon ta mbrojë çmimin nga presioni i jashtëm nga shitës librash, botues, dhe të tjerë që mundë të kenë interes të influencojnë rezultatin.

Shpallja e Çmimit Neustadt u bë në recepsionin e Universitetit të Oklahomës në 16 tetor 2019.

Çmimi Neustadt është çmimi letrar i parë ndërkombëtar i llojit të tij i krijuar në Amerikë dhe një nga çmimet e pakta ndërkombëtare në të cilën poetët, romancierët, dhe dramaturgët janë të pranuar në mënyrë të barabartë. Fituesve u jepet një çmim prej $50,000, një replikë e një pende shqiponje prej argjendi dhe një certifikatë. Një pasuri bujare nga familja Neustadt e Dallas, Teksas; Denver, Kolorado; dhe Watertown, Massachusetts, siguron çmimin në përjetësi.



"Një pasardhës letrar i George Orwell dhe Franz Kafka-s, vepra e Ismail Kadaresë është po aq me imagjinatë sa është dhe filozofike. Në kërkimin e saj këmbëngulës për të vërtetën dhe drejtësinë, ajo lidhet me historinë dhe politikën në një mënyrë radikale dhe dinamike.

Histori: Çmimi Ndërkombëtar Neustadt për Letërsi

Çmimi është themeluar më 1969 si Books Abroad International Prize for Literature, më pas riemëruar Books Abroad / Neustadt Prize para se të merrte emrin e tanishëm më 1976, The Neustadt International Prize for Literature. Çmimi Neustadt është çmimi letrar i parë ndërkombëtar i llojit të tij i krijuar në Amerikë dhe një nga çmimet e pakta ndërkombëtare në të cilën poetët, romancierët, dhe dramaturgët janë të pranuar në mënyrë të barabartë. Konsiderohet gjerësisht çmimi ndërkombëtar letrar më prestigjoz pas Çmimit Nobel në Letërsi dhe, në fakt, referohet shpesh si "Nobeli Amerikan" për shkak të rekordit të tij me 32 fitues, të cilët në 48 vitet e kaluara kanë fituar çmim Nobel pas Çmimit Neustadt.

Statuti i Çmimit Neustadt

Statuti i Çmimit Neustadt përcakton që çmimi të jepetpër arritjev të jashtëzakonshme në poezi, prozë, ose dramë, dhe që të jepet vetëm në bazë të meritës letrare. Cilido shkrimtar i gjallë i çdo gjuhe është i pranueshëm, me kusht që të paktën një pjesë përfaqësuese e veprës së tij ose saj të jetë e botuar në anglisht, gjuha e përdorur gjatë diskutimeve të jurisë. Çmimi mund të shërbejë për të kurorëzuar arritjet gjatë gjithë jetës, ose drejton vëmendjen te një vepër e rëndësishme jetësore që është ende në zhvillim.

"Që nga fillimi i tij, Books Abroad kanë shfaqur një shqetësim të madh për zgjedhjet vjetore të bëra nga Akademia Suedeze për atë më të respektuarit e çmimeve, çmimin Nobel për Letërsinë. Kur vendosëm të jepnim për herë të parë Çmimin Neustadt, Profesori Herbert Howarth… rekomandoi që poetët dhe dramaturgët të konsiderohen njësoj me romancierët; që çmimi jo domosdoshmërisht të kurorëzojë veprën e një jete, por duhet që me raste të drejtojë vëmendjen ndaj një pune të rëndësishme jetësore në zhvillim; më në fund, që autorët nga letërsitë më pak të njohura nuk duhet të konsiderohen si më pak të privilegjuarit. Çmimi Neustadt ka për qëllim të jetë … përfaqësues i shqetësimit amerikan për arritje të vërtetë në letërsinë botërore."

- Ivar Ivask, "Preamble", Books Abroad 43: 4 (Vjeshtë 1969)

"Serioziteti i zgjedhjeve përfundimtare të

jurisë është ndoshta i ilustruar më së miri duke theksuar karakterin ndërkombëtar të listës së kandidatëve që rezultojnë, ku një shkrimtar islandez prezanton një romancier kolumbian, një poet izraelit zgjedh një poet jugosllav, ndërsa një amerikan poet-kritik zgjedh një koleg polak. Kështu, mjaft spontanisht besimi në vlerësimin e paanshëm letrar në një shkallë botërore, të cilën kjo revistë e ka përkrahur tani për dyzet e gjashtë vjet, është përsëri e shfajësuar." - Ivar Ivask, "Redaktori Parenthesizes", Books Abroad 46: 3 (Verë 1972), 426

Familja Neustadt

Mbështetja e madhe e familjes Neustadt kundrejt Universitetit të Oklahomas ka qenë thelbësore për zhvillimin e instituticionit. Që nga dhurimi i tokës për universitetin për Max Westheimer Airpark te shtesa Neustadt Wing për Bizzell Memorial Library, sponorizuar nga Çmimi Ndërkombëtar Neustadt për Letërsinë, dhe themelimit të Neustadt Professorship në Letërsi Krahasuese, përmes tre brezash aktivë, lidershipi vizionar, familja Neustadt ka promovouar përsosmëri në edukimin e lartë.

Familja Neustadt financoi atë që atëherë njihej si Books Abroad International Prize for Literature në 1972. Walter Neustadt Jr. (1919–2010) ka marrë diplomën e masterit nga Universiteti i Oklahomës në 1941 dhe ishte anëtar i Board of Regents dhe një i besuar i Fondacionit të UO kur Presidenti Paul F. Sharp shpalli dhuratën $200,000 më 17 Maj, 1972. Çmimi mori emrin e sotshëm Neustadt International Prize for Literature, në 1976. Më 1992 Walter mori Çmimin e Arteve të Guvernatorit të Oklahomës për mbështetjen e tij për letërsinë dhe artet dhe një nderim si Doktor i Letrave Humane nga UO në 2005.

Me çmimin NSK Neustadt për Letërsinë e Fëmijëve, një brez i ri i familjes Neustadt ia ka dedikuar veten përparimit të kauzës së përsosmërisë letrare në Universitetin e Oklahomës. Shkronjat "NSK" janë për Nancy, Susan dhe Kathy, fëmijët e Walter dhe Dolores Neustadt dhe financuesit e çmimit. Tri motrat vendosën të nxisin përmirësimin e letërsisë për fëmijë duke nderuar një shkrimtar bashkëkohor ose ilustrues të letërsisë për fëmijë çdo dy vjet. Që të tre u nderuan me çmimet Alumni të Regents në 2011 për përkushtimin dhe shërbimin e tyre në universitet.



"Ne pranojmë se fuqia e fjalës së shkruar është një përgjigje ndaj një kuptimi më të gjerë ndërmjet njerëzve të botës, e si rezultat, ndaj një jetese më të paqtë dhe bashkëpunuese me njëri tjetrin, brenda këtij universi që sa vjen e ngushtohet.
—Walter Neustadt Jr.

Fituesit e Neustadt

2018 – Edwidge Danticat
2016 – Dubravka Ugrešić
2014 – Mia Couto
2012 – Rohinton Mistry
2010 – Duo Duo
2008 – Patricia Grace
2006 – Claribel Alegría
2004 – Adam Zagajewski
2002 – Álvaro Mutis
2000 – David Malouf
1998 – Nuruddin Farah
1996 – Assia Djebar
1994 – Kamau Brathwaite
1992 – João Cabral de Melo Neto
1990 – Tomas Tranströmer
1988 – Raja Rao
1986 – Max Frisch
1984 – Paavo Haavikko
1982 – Octavio Paz
1980 – Josef Škvorecký
1978 – Czesław Miłosz
1976 – Elizabeth Bishop
1974 – Francis Ponge
1972 – Gabriel García Márquez
1970 – Giuseppe Ungaretti

MUNGESA E STENDËS "ALBANIA" NË PANAIRIN E LIBRIT NË FRANKFURT DHE TETORI I LIBRIT NË TIRANË

nga Bujar Hudhri

Prej shumë vjetësh stenda "Albania" mungon në Panairin më të madh në botë që organizohet çdo vit në mes të muajit tetor. Është një shpërfillje e përvitshme që shteti shqiptar i bën një ngjarjeje me përmasa botërore në fushë të kulturës.

Dhe nuk bën dallim nëse është qeverisje e majtë apo e djathtë, të gjithë e kanë fshirë prej kohësh nga agjenda e tyre njërin nga detyrimet bazë që kanë për mbështetjen dhe promovimin kulturës së vendit.

Kjo mungesë e padurueshme, kjo vetmi e librit shqip, bëhet edhe më alarmuese kur sheh stendat e shteteve që na rrethojnë. Duke filluar me Kosovën, me një stendë impresionuese, e sponsorizuar çdo vit nga Ministria e saj Kulturës. Po ashtu shtetet e tjera, si Maqedonia, Sllovenia, Kroacia, Serbia etj. Por edhe të gjitha shtetet europiane dhe të botës. Nuk e ke të vështirë të lexosh të njëjtat fjalë: *Mbështetur nga Ministria e Kulturës x, y, z*. Pra, një stendë e veçantë me emrin e shtetit dhe stenda të panumërta të botuesve privatë të po këtyre vendeve. Me një fjalë, shteti merr prodhimin letrar që botuesit privatë e kanë realizuar brenda një viti dhe e paraqet, e përball me kulturat e tjera. Dhe të mendosh për botuesit e huaj privatë, me një përvojë mbi shekullore, të fortë ekonomikisht, megjithatë shteti i tyre u rri pranë. Sepse shteti ka për detyrë që kulturën e tij ta përhapë në të gjitha gjuhët.

Ka me dhjetëra shkrimtarë shqiptarë që janë botuar në gjuhë të tjera, sikundër ka të tjerë, të rinj, që mund të paraqiten në këtë stendë duke u dhënë shansin që të bien në kontakt me botues, agjentë, përkthyes nga gjithë bota.

Dhe diçka tjetër: duke mos pasur një stendë "Albania", a mund të kërkojmë ne që autorët shqiptarë shtetas të Serbisë, Maqedonisë së Veriut apo Malit të Zi, të jenë të përfaqësuar proporcionalisht me kolegët e tyre në këto vende?

Nëse ka ndonjë panair tjetër ku stenda "Albania" mund të paraqitet me dinjitet përballë botës kulturore, cili mund të jetë përveç këtij panairi? Kur Shqipëria pret çdo vit që shkrimtari i saj i famshëm, Kadare, kandidat për *Nobel*, të marrë me meritë këtë çmim, a nuk është e qartë se stenda "Albania" mund veçohet nga qindra stendat e tjera edhe të vendeve më të mëdha të botës, që nuk e presin një lajm të tillë?

Por kjo stendë mungon dhe zbrazëtia nuk mund të mbushet kurrë me veprimtaritë anemike që organizohen nga Ministria e Kulturës në tetorin e librit në Tiranë.

Maqedonia e Veriut

Kroacia

Sllovenia

Sllovakia

Shtëpia Botuese Onufri dhe Minerva



Kosova

RUDOLF MARKU:
Të shkruash pa pasur lexues,është si të vallëzosh në errësirë

Intervistoi: Violeta Murati

Në biografinë tuaj lexojmë disa peripeci të nëndheshme, që prej jush nuk e kemi të plotë si rrëfim... çfarë ka ndodhur: poezitë, liria, miqësitë, mbijetesa ç'kanë qenë këto, nëse do t'i quajmë sublimitete, në vitet '80? A mendoni se jeta *underground* është më e bukur?

E gjithë krijimtaria letrare dhe artistike, në fund të fundit, është një krijimtari *underground*. Sepse shpirti njerëzor është *underground*. Krijimtaria synon të shpalosë thellësinë e qenies njerëzore. Në këtë kuptim, krijimtaria artistike është vetvetiu *underground* – jo në nëntekstin politik sesa në atë shpirtëror. Miqësia ime me poetët Ndoc Gjetja dhe Preç Zogaj ka qenë një stimul i jashtëzakonshëm artistik, pikërisht sepse ishte një rrëfim i sinqertë i krijimtarisë sonë si *undeground* shpirtëror. Leximi i poezive me njëri-tjetrin, aftësia për t'iu gëzuar krijimtarisë së njëri-tjetrit, dashuria e jashtëzakonshme për librat e bukur dhe autorët e mëdhenj... Më duket se askush tjetër nuk e ka dhënë pikturën e jetës sonë të atyre viteve më saktë dhe në mënyrën më prekëse sesa studiuesi dhe akademiku erudit Gëzim Basha, një njohës *par excellence* i letërsisë. A mund t'i gëzohen shkrimtarët e sotëm krijimtarisë së njëri-tjetrit, tani, në kushtet e lirisë? Lezha filloi të bëhej një qytet pelegrinazhi artistik – vinin që të na takonin Petro Marko, Ismail Kadare, Frederik Reshpja, Dritëro Agolli, Visar Zhiti, Bujar Xhaferri, Bashkim Shehu (me fisnikërinë e vet për të na marrë nën mbrojtje), Xhevair Spahiu, Moikom Zeqo, Bardhyl Londo, piktori i talentuar Bujar Golemi, i madhi Petro Zheji, e plot krijues të tjerë. Megjithatë, mendoj se vetë krijimtaria artistike fillon përpara procesit të shkrimit. Ajo fillon me fëmijërinë. Një poet i njohur anglez thotë se Krishti u tradhtua nga fëminia e Judës. Nga fëminia e mjerë e Judës. Nga pa-aftësia e Judës për të qenë fëmijë. Në të kundërt, Lezha ishte qyteti më ideal për të qenë fëmijë. Që 12 vjeç lexoja Hakelber Finin dhe Tom Sojerin, dhe më dukeshin se ngjarjet e librit ndodhnin në qytetin tonë. Natën çlidhnim varkat e peshkatarëve për të lundruar në lumin Drin dhe i gjithë qyteti vihej në kërkimin tonë, sepse qe hapur lajmi se qemë mbytur në lumë... Vidhnim rrjetat e peshkatarëve që vetëm e vetëm t'i lëshonim peshqit përsëri në lumë, sepse na vinte keq. Ditën ngjiteshim në malin përballë qytetit për të bërë aventurat tona brenda mureve të kalasë – përbetime lidhjesh sekrete si ato të mesjetës, komplote kundër profesorëve që nuk na pëlqenin, përbetime kundër Rushit Jevgut, policit të rreptë të qytetit. Dhe menjëherë pas këtyre aventurave, vinin librat dhe leximi i tyre ulur në shkallët e jashtme të shtëpisë, buzë rrugës, jo larg nga lumi Drin. Lexonim me zë të lartë. Pastaj vinte teatri që shfaqnim ne, fëmijët, në çardakët e mëdhenj të shtëpive. Loznim *Hamletin* (variantin tonë të *Hamletit*) dhe *Fëmijët e Rrugës Pal*... Bileta: 2 lekë të vjetra. Pastaj tipat e jashtëzakonshëm të Lezhës: Marka Fana, njëfarë kryetar i paligjshëm i OKB-së, Antonio Luna që ngulte këmbë se sapo qe kthyer nga një udhëtim në hënë, Pali i Kallmetit, Shyqi i Çelësit Anglez, Dulaq Lekiqi, që besohej se natën varte në litar macet e qytetit, Abaz Kalibobja, Dan Kasuqja – shoku im i bankës, Lali i Memës, qyteti mesjetar me rrugë me kalldrëme, rrugë dhe rrugica të shtrembëta dhe të ngushta ku nuk mund të kalonte një njeri së bashku me biçikletën e vet... Poezia pati filluar te kjo fëmini. Dhe sa shumë trishtohem tek mendoj se qytetet tona moderne tani janë kundër fëminisë – se një fëmijë i sotëm kurrën e kurrës nuk mund ta ketë atë gëzim fantast të aventurave *outdoors* që na i ofronin me aq bujari qytetet tona të rrënuara provinciale... Asnjë qytet modern nuk mund t'ia krijojë atë lehtësi fantazie një fëmije sa ç'na i krijonte ne, fëmijëve, qyteti ynë i rrënuar... Më vonë, kur fillova të shkruaj, ndjeva atë zhgënjim që ndien çdo shkrimtar fillestar – Kishim ardhur Vonë! Brezi të cilit i përkisnim, e fillon krijimtarinë në vitet më të vështira në historinë e letërsisë, kur kontrolli partiak ia kalon çdo shembulli të censurës në letërsinë botërore. Njëra ndër poezitë e para që kam shkruar dhe kam botuar ka qenë ajo me titullin "I vonuari", për të cilën miku im me një kujtesë të ndërgjegjshme mirësie, poeti Visar Zhiti, ka shkruar se tingëllonte si një manifest i dëshpëruar i brezit tonë.

Keni shkruar shtatë vëllime poetike, romanet "Allahland", "Tre divorcet e zotit Viktor N.", "Kësulëkuqja vjen me trenin e dhjetës", keni përkthyer që herët në shqip T. S. Eliot-in, Ezra Pound-in, W. Oden-in, K. Kavafis-in, G. Ungaretti-n, James Joyce-in dhe shumë autorë të tjerë të njohur të shekullit XX. Keni meritën e prezantimit për herë të parë lexuesit shqiptar të shumë autorëve të huaj të konsideruar të ndaluar. Në këtë biografi të shpejtë letrare, kaq të angazhuar, cili është shqetësimi që mbizotëron, a e ndieni përmbushjen?

E gjitha kjo që përmendni ju është fare pak në krahasim me atë që duhet të bëjë një shkrimtar në kohërat kur letërsia e mirë ndalohet. Jo vetëm që nuk ndiej asnjë përmbushje, por, në të kundërt, ndiej një keqardhje për gjithë atë kohë kur letërsia e mirë botërore na ndalohej në mënyrën më absurde. Sa për krijimtarinë – për krijimtarinë origjinale – ajo është krijuar në kohëra tepër të vështira, duke ia dhënë në mënyrë të pashmangshme haraqet e veta Polifemit që kontrollonte daljen e Shpellës.

Në vitin 1997 ju jeni zhvendosur në Londër bashkë me familjen dhe qëndruat atje edhe pas detyrës zyrtare. Pse ky vendim?

Në vitin 1997, vetëm dy muaj pas emërimit tim në Ambasadë, mora një urdhër të kthehesha "në mëmëdhe" – siç shkruhej në letrën zyrtaro-patriotike të ministrit të Jashtëm. Qe një vendim hakmarrës politik! Vendosa të qëndroja së bashku me familjen në Londër. Mos harro se ishte viti 1997! Në ditën e nesërme të pushimit nga puna prej shtetit shqiptar, m'u ofrua një post në British Refugee Council, ku kam ndihmuar dhjetëra dhe qindra azilkërkues shqiptarë dhe të ardhur nga vendet ish-komuniste për t'u bërë shtetas britanikë.

Lezha – një qytet, për habi, që ka zanafillën pothuaj të brezit dhe një qark letrar që bëri bujë, – edhe sot e ruan namin e atyre viteve. Ç'ishte ky qytet për ju, pse mendoni se u bë një "tokë" letrare kaq e identifikueshme?

Lezha është qyteti i lindjes, një qytet provincial, me tipat më të çuditshëm që mund të imagjinosh. "Provinca është edhe ambienti më i mirë për të shkruar letërsi", - thoshte Nikolaj Gogol, ky shkrimtar i jashtëzakonshëm. Kadare e ka dëshmuar këtë të vërtetë të madhe kur shkroi veprën e vet më të mirë "Qyteti në gur". Por nuk duhet harruar edhe tradita letrare e Lezhës. Me Lezhën lidhen emrat e Frang Bardhit, Mjedës dhe Fishtës, tre emra të shquar të letërsisë dhe kulturës kombëtare. Mësuesi im i letërsisë, Luigj Ljarja, na thoshte shpesh në klasë, me një përhumbje sikur të ishte duke folur nga shekujt e kaluar: E më kujtohet njëherë se si mësuesi im, Ndre Mjeda... Por, mbi gjithçka, ishte qyteti ku ndodhej Varri i Skënderbeut, jo më larg se 200 metra nga shtëpia ku banonim. Skënderbeu ishte për ne një emër për të cilin flisnin librat, legjendat, filmat dhe ai, i vdekur, ishte fizikisht fare pranë nesh. Në Lezhë ndihej në çdo hap Historia. Shtëpitë qenë ndërtuar shpesh mbi muret e mëdha të qytetit ilirik; ne luanim me artefaktet antike – me monedhat e kohës së Filipit të Dytë të Maqedonisë, të të atit të Aleksandrit të Madh; sillnim në shtëpira lakrimore romake, heshta bronzi, thika të epokës së gurit, skulptura perëndish greke... Një shoku im i fëminisë, Dan Kasuqja, madje pati arritur të blinte me një monedhë të Perandorisë Romake dy akullore, duke ia mbushur mendjen shitësit se qenë monedha ari të kohës së Zogut. Natyrisht, fëmijë, ne nuk mendonim për historinë, as për ngjarjet e saj dhe as për njerëzit e mëdhenj të saj. Por historinë e thithte si një sfungjer subkonshi ynë fëminor për kohëra e mëvonshme. Për ato kohëra

kur arrijmë të jemi të vetëdijshëm se njeriu qenka një kafshë historike. Dhe atëherë fillon edhe krijimtaria letrare, poezia, piktura... Së bashku me miqtë e mi poetë, Ndoc Gjetjen dhe Preç Zogajn, por dhe me një brez poetësh të mëvonshëm (Shpresa Kapisyzi, Mark Simoni, Alfons Zeneli, Ferdinant Nika, Pjeter Jaku dhe romancierët Kujtim Dashi dhe Salvador Gjeçi) dhe me një brez piktorësh të talentuar (dy vëllezërit Ivanaj, Nikolini dhe Frederiku, Pashk Përvathi, Martin Luca, Agustin Shyti), arritëm të krijojmë një traditë poetike që bëri ta dallonte Lezhën nga përgjumja provinciale e shumë qyteteve të tjera të vendit.

Poezia e parë, botimi i parë... çfarë ruani në kujtesë?
Poezitë e para i kam botuar që në moshën 18-vjeçare. Tërhoqën përnjëherë vëmendjen e botës letrare, si poezi tjetërlloj. Cikli i parë poetik shoqërohej me një fotografi paksa "moderne" për standardin e kohës. Më kujtohet se kishte njerëz që thanë (duke u nisur dhe nga emri) se ky autor nuk është shqiptar. Që në ciklin e parë u botuan poezitë "I vonuari" dhe "Njeriu që nuk dua ta njoh". Për poezinë e parë Visar Zhiti ka shkruar se "...qysh në kapërcyell të viteve '70 të shekullit që kaloi, Rudolfi student botoi poezi marramendëse, ngaqë ishin disi ndryshe nga ato të socrealizmit. Fati i poezisë "I vonuari", duke i shpëtuar censurës, mund të ishte, sipas meje, himni i heshtur i brezit tonë, *credo*-ja e thyer dhe ngushëllimi kolektiv i atyre të pafatëve të ndëshkuar të jenë brezi pas fitimtarëve, aq më keq në diktatura:

E kotë britma për ty,
mbyte dhembjen pa mëshirë,
se unë e di ç'do të thotë
të jesh i vonë dhe i mirë.

...Megjithatë
shoqëroje veten
me hapat e tua."

"Poetët janë qytetarë të Ferrit/ I mbushin penat e tyre me squfur, me gjakun e vet/ Me ëndrrat e të panjohurve, me rrëfime fantazmash", - kështu shkruani në një poezi tuajën. Sa poet keni mbetur, si vjen ky zë?
Që në nisjet e mia, kur fillova të shkruaj e të botoj poezitë e para, shkrova dhe botova natyrshëm edhe tregimet e para. Kanë qenë tregime origjinale po aq sa edhe poezitë. Është ndër gjërat më prekëse të jetës sime njohja, shumë e shumë vjet më vonë, me komentet lavdëruese për njërin nga këto tregime, bërë nga dy poetët e masakruar më vonë, Genc Leka dhe Vilson Blloshmi. Visar Zhiti ka treguar se në hetuesi, gjatë torturave, e kanë pyetur me shumë interes për poezitë e mia përreth një muaj me radhë! Kjo më ka dhënë zemër. Paskam pasur lexues të mitë dhe në radhët e kasapëve dhe nuk e paskësha ditur! Poezia është fryma e gjithë arteve të tjera. Ndonjëherë mendoj se, kur pushon së ndjeri poet, pushon dhe krijimtaria artistike – e çfarëdollojshme.

Në vitin 1973 keni botuar vëllimin poetik "Shokët e mi", i cili kritikohet nga shtypi si një libër me gabime ideologjike... Libri u ndalua, çfarë nxiti te ju kjo situatë, kuptimi që mori te ju të qenët poet, koshienca?
Libri im i parë poetik u hoq nga qarkullimi pasi u botua një shkrim kritik në një faqe gazete me titull "Në 8 vargje poetike, 8 gabime ideologjike!". Qe një De Ci Bao e stilit të kohës së revolucionit kultural kinez. Ishte viti 1973! Më hoqën nga gjimnazi. Më e keqja ishte kur në Plenumin e Katërt të KQ-së poezia ime me titull "Lidhjet e mia me natyrën" u kritikua, në prezencën e Enver Hoxhës, nga kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të asaj kohe për gabime ideologjike. Pas kësaj m'u desh të shkruaja ca nga poezitë e mia më të këqija, për botim, për t'i shpëtuar arrestimit, në një kohë kur në shtëpi merresha privatisht me përkthimin e James Joyce-it dhe të T. S. Eliot-it. Por çështja e censurës te ne ka qenë njëra nga çështjet më groteske: në një letër që shtëpia botuese "Naim Frashëri" ia dërgon Zyrës së Shtypit në Komitetin Qendror dhe kjo e fundit ua dërgon 4 anëtarëve të Byrosë Politike (përfshirë dhe Ramiz Alisë), kritikohen 2 poezi të miat, krahas krijimtarisë së tre poetëve të tjerë. Të dyja poezitë e kritikuara kam arritur t'i botoj më vonë në libër, pa i shkuar ndër mend askujt se qenë po ato poezi që ishin kritikuar më parë. Njëra prej atyre poezive, ajo me titullin "Ka një gabim në lindjen e ditës", është një poezi dashurie të cilën mund ta përfshij në çdo Antologji të Poezisë Botërore. Më kujtohet një bisedë interesante që kam pasur me poetin Fatos Arapi, që e kisha profesor dhe mik. Më thoshte se çështja e censurës te ne është paradoksi se nuk ka një zyrë censure. Po të kishte një Zyrë Censure, krijuesi do ta kishte më të lehtë të dinte se çfarë lejohej e çfarë nuk lejohej. Papërcaktueshmëria e censurimit bënte që çdo gjë t'i nënshtrohej censurës. Mirëpo një papërcaktueshmëri e tillë bënte që shpesh censurës t'i kalonin nën hundë vepra dhe krijime që radari i saj mediokër nuk arrinte t'i kapte.

Nga viti 1987 deri në vitin 1990 keni punuar në gazetën "Drita", ku drejtonit botimin e poezisë dhe të përkthimeve. Ka disa mendime kontradiktore për të si një mundësi shprehjeje, por që përdorej nga regjimi dhe që në mënyrën e saj i shërbeu makinës së diktaturës. Ju ç'kuptim do t'i jepnit? Ç'ishte ajo kohë kur ju punonit për të?
Çështja e lirisë dhe e diktaturës nuk kanë qenë e kurrë nuk do të jenë një hapësirë bardhezi. Liria artistike është e ndryshme nga liria politike. Mund të jesh mbreti a presidenti i një vendi, politikisht njeriu më i lirë i atij vendi, dhe kur merr të krijosh, mund të jesh i lidhur me zinxhirët e mediokritetit. Mund të jesh në burg, si Dostojevski, duke pritur dënimin me vdekje, dhe artistikisht, tek shkruan, je njeriu më i lirë, falë lirisë së brendshme që është shpirti. Në atë gazetë, "Drita", gjatë atyre viteve që kam punuar kam arritur të botoj përkthimet e mia të T. S. Eliotit, fragmente nga romani "Shakaja" të Kunderës, memuare të Luftës së Dytë Botërore të Çërçill-it, dhe kam arritur të përmend pozitivisht, për herë të parë që nga viti 1944, emrat e Gjergj Fishtës, Ernest Koliqit dhe të George Orwell-it, e sa e sa të tjerëve. Dhe jo vetëm unë. Të gjithë kolegët e mi që punonim asokohe në gazetën "Drita" – Zijai, Bardhyli, Teodori, Ida, Skënderi, Arbeni... Më kujtohet se si një marksist grek pati ardhur të ankohej te zyra e Dritëroit, Lidhja e Shkrimtarëve, se kisha guxuar të shkruaj për Anxhelopulos-in në gazetën "Drita", regjisorin e famshëm grek i cili, sipas marksistit grek, qe një reaksionar i padenjë të përmendej e të lavdërohej. Kam qenë redaktor i gazetës "Drita" kur pata marrë një letër miqësore përgëzuese rreth poezive të mia nga Martin Camaj, që më shkruante nga Munihu, e po ashtu dhe nga Joachim Langsh, i cili ka shkruar as më shumë e as më pak se "autorët, si Rudolf Marku, ishin autorë me një këmbë në burg dhe me këmbën tjetër jashtë". Po në ato vite (1988), gazeta "Dielli" e "Vatrës" në Boston ka botuar një faqe gazete me poezitë e mia, me një shkrim të Ylli Egrenit, i cili shprehte çudinë se si Rudolf Marku, një poet që jeton





në një vend ku mbret është Terrori dhe mbretëreshë Hipokrizia, arrin të shkruajë e të botojë poezi të tilla si ato që m'i ribotonte "Dielli", pa përmendur dhe dashamirësinë e vlerësimit të Arshi Pipës ndaj poezive të mia. Asokohe ishte gazeta "Zëri i popullit" që me një gjest të paparë në shtypin e centralizuar komunist kritikonte për shkarje gabimesh ideologjike gazetën "Drita"... Asokohe Preç Zogaj, krahas poezive të veta lirike të një emancipimi tërë dritë estetike, kishte filluar të botonte e të inkurajonte zemërgjerësisht ca poetë të rinj të talentuar në gazetën ku punonte ai... Më falni që i përmenda të gjitha këto, por sot ekziston një *short-memory* e çuditshme, një gatishmëri për një cinizëm të lig dhe akuzues ose, në rastin më të mirë, mohues, që rrjedh nga sfrustracioni i mungesës së talentit të atyre që akuzojnë, – premisë numër një e arsyes së vetërobërimit në kushtet politike të lirisë!

"Allahland" është një roman satirik konician; karikatura e politikës dhe gazetarisë shqiptare së tranzicionit... duket sikur Shqipëria "shihet" më mirë nga jashtë, në distancë? Pse?
Distancat të japin dorë për t'i parë gjërat më mirë, qofshin këto distanca gjeografike a kohore. Duhet të ngjitesh në majën e një kodre që të shohësh urbanistikën e qytetit. Kur je duke ecur nëpër rrugë a rrugica, nuk mund ta shohësh të tërën.

"Tashmë që kam arrit moshën e babait tim/ Pa asnjë ndrojtje, pa asnjë kompleks edipian/ E ftoj për një gotë në klub. Ashtë vonë/ Ecim rrugëve dhe na pëlqen të shohim vajzat e natës/ Nuk ka rëndësi nëse janë prostituta a të virgjëra/ E siguroj se çdo gjë do mbetet mes nesh... – Ç'është ky "dialog i pamundur" (kështu e titullon edhe poezinë). Ju gjeni një mënyrë për të shprehur se çfarë është ky raport mes atit dhe birit, ka disa autorë këtu në përpjekjen për të dhënë këtë trajtesë në letërsi? Pse tërheq?
Mendoj se raporti i birit me babanë është një raport i përjetshëm. Jo në kuptimin skematik (madje dhe të lig) të Frojdit. Është një temë natyralisht e përjetshme e njerëzimit! Ati, biri dhe Shpirti i Shenjtë është triniteti hyjnor i Biblës, që e ka pikënisjen pikërisht te kjo lidhje e jashtëzakonshme e qenies njerëzore e të Birit me të Atin. A nuk është edhe vetë *Hamleti* një tragjedi kundër përpjekjes për ta çnatyralizuar këtë lidhje?

Duket se të qenët në ekzil, ndryshe nga të tjerët, ju e përjetoni jo duke shkruar një letërsi të tillë, por duke perceptuar e duke ruajtur kujtesën, siç dëshmojnë vargjet: "E di se këtu Kujtesa vret më tepër se Terrori..." Pse kjo qasje?
Në këngën e pestë të "Metamorfozave", të titulluar "Minerva dhe Muzat", Ovidi, njëri ndër poetët e mi më të preferuar, na kujton se: "Muzat janë bijat fatlume të Kujtesës..." Ovidi, ndryshe nga shumë poetë bashkëkohorë, mendonte se harresa, amnezia, është vdekja e krijimtarisë artistike. Heminguej vrau veten në çastet kur u bë i vetëdijshëm se po e linte kujtesa, që për të do të thoshte vdekja e krijimtarisë letrare.

"Tre divorcet e Viktor N." është romani që ju bëri të parin shkrimtar që nderohet me çmimin letrar "Kadare". Një roman mbi zhgënjimin e madh të një shqiptari që jeton prej 15 vjetësh në Londër – ky është përcaktimi që keni dhënë në një intervistë. Përse shkruani? Kur është koha e "brumit" letrar për ju?
Besoj se është një pyetje për kritikët. Natyrisht, nëse denjojnë ta lexojnë këtë libër përpara se ta shajnë atë!

Ndalemi pak më gjatë tek antologjia "...Retë që shkasin atje tej, retë e mrekullueshme..." botuar së fundi, që përfshin 40 vjet shqipërime poetike në disa gjuhë, e konsideruar ngjarje, me autorë klasikë. Janë 76 poetë me 126 tituj me prirje nga lirikat e dashurisë dhe poezinë alegorike, – jo domosdoshmërisht më të bukurat sipas jush, por me shije personale; ç'nxitje ishte, si janë përkthyer, si ka qenë ky proces në shqip?
Përkthimi është një proces i natyrshëm për shkrimtarin. Kam përkthyer që herët, si një ushtrim për të zbuluar ca nga sekretet e procesit të krijimit. Por dhe thjesht për ta shpërndarë kënaqësinë e leximit me miqtë e mi, me ata miq të cilët i kam përmendur në krye të intervistës. Letërsia ishte për mua dhe miqtë e mi një Festë, një Treat, një gëzim që duhej ndarë me të tjerët. Të paktën kështu mendonim asokohe bashkë me Ndocin, me Preçin, me Frederikun, me Visarin, Zijain, Bujar Xhaferrin e plot të tjerë. Përkthimi ishte mbajtja gjallë e kujtesës së letërsisë së mirë kur përreth buçisnin trumbetat dhe daullet kakofonike të festave të mëdha.

E nisni me Safon, një cikël të plotë, për të cilën është thënë se të tjerët pas saj vetëm kanë shkruar vargje; Safo është e vetmja që ka shkruar poezi. E morën këtë edhe për faktin e përfshirjes së historisë suaj në këto përkthime, ç'ka qenë kjo përvojë e moshës 18-vjeçare, pak ekstravagante për një poete të tillë, krahasuar me pasionin tënd?
Safo mbetet poetesha më e madhe e njerëzimit. Në moshën 18-vjeçare kishim lexuar Shekspirin, Homerin, Dante Aligierin, Witman-in, Heminguejn, Gëten, Dikensin, Bajronin, Kitsin e plot autorë të tjerë. Unë dhe miqtë e mi. Kështu që njohjen me poezinë e Safos e pranuam përnjëherë si një njohje që e meritonim. Si një element kimik që, pa u zbuluar ende, e kishte kutinë bosh në kutinë e elementëve. Dua të them se një poete si Safo, edhe pa e lexuar, ndihet se mund të ketë ekzistuar prej shekujsh, dhe ti pret vetëm që një ditë ta njohësh dhe ta lexosh.

Në parathënie thoni se janë poezi që kanë një jetë më të gjatë në shqip, rreth 40 vjet më parë. Ç'ishte kjo histori, duke pasur parasysh brezin tuaj të viteve '70-'80 dhe sistemin ku ishin të "detyruar" të jetonin shqiptarët, diktaturën? Nga kjo përvojë ju keni një mendimin mbi lirinë, si e perceptonit?
Liria është një gjendje e brendshme e shpirtit. Për shkrimtarin, është çështje e talentit. Shekspiri e shkruan *Makbethin* në kohën e kufizimit më të madh që ka pasur në jetë. Në fron kanë ardhur Stjuardët dhe mbreti Xhejms e porosit Shekspirin të shkruajë një dramë. Nënteksti – të shkruajë një dramë lavdëruese për Stjuardët. Oborrtarët e Pallatit e këshillojnë Sheskpirin të shkruajë një dramë sa më të shkurtër, ngase drama do të shfaqet për mbretin dhe mbretin na e zënka gjumi shpejt. Pra, një dramë me porosi, një dramë-furçë për mbretin dhe një dramë që duhet të ketë parasysh që të mos ia prishë gjumin mbretit. Duket se me të gjitha këto kushtëzime banale, me gjithë këtë mungesë lirie, Shekspiri do të shkruajë veprën e vet më të dobët. Në fakt, me të gjitha këto rrethana, ai shkruan *Makbethin*, veprën më të fuqishme të vetën. Sepse në letërsi liria nuk është liria politike, por liria e gjuhës, liria e brendshme e shpirtit, e talentit të shprehjes.

Gabimi, koprracia, mëkati, marrëzia/ Na pushtojnë në shpirt e na mundojnë në trup/ Ne ushqejmë pendimet tona më në fund/ Siç ushqejnë lypësit morrat me mijëra./ Kokëfortë i kem' mëkatet, pendohemi me frikë/ Pendimet i paguajmë me çmim të lartë... Këto vargje të Bodlerit nga "Lexuesi"-i... çfarë reflektimi ju shkakton?
Mendoj se Bodleri nuk ka nevojë as për lavdërimin dhe as për shpjegimin tim!

Kur keni prezantuar poetin Preç Zogaj, citonit poetin francez Paul Valery, që kishte zakon të këshillonte të tjerët, sidomos veten e vet, duke kërkuar gjithmonë të falur para se të fliste për poezinë... çfarë është poezia, vjen pyetja, si do të përgjigjeshit? Çfarë ju bën të besoni te poezia?
Nga milionat e përcaktimeve të poezisë, më pëlqen ajo që thotë Ezra Pound: "The Poetry is the dance of the intellect among the Words!" Ndoshta më pëlqen se është më afër edhe me konceptimin tim të poezisë. Por e di se poezia e mirë ndoshta meriton përcaktime ende më të bukura!

Si e mendoni lexuesin tuaj ideal?
Parapëlqej një lexues që lexon pa paragjykime; që lexon për kënaqësinë e vet dhe që nuk rrehet nga emrat e mëdhenj të autorëve, sidomos jo nga lavdia mediatike e autorit. Më duket se Ovidi mbi 2000-vjeçar e ka thënë më bukur nga të gjithë raportin e shkrimtarit me lexuesin, tek shkruante se "të krijosh një vepër letrare pa pasur asnjë lexues, është si të vallëzosh i vetëm në errësirë". Kësisoj më duket se shkrimtarit i duhet t'i jetë mirënjohës çdo lexuesi të veprës së vet, edhe atij lexuesit që e lexon veprën në një mënyrë krejt tjetërsoj nga kritikët, profesorët, akademikët. Madje, autorët i mbesin borxh sidomos këtij lexuesi "të pakualifikuar".



Një tubim i rëndësishëm shkencor albanologjik në Universitetin e Zarës

Evalda PACI

Në datat 3-5 tetor 2019 në Universitetin e Zarës u zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare me temë qendrore *Symbiosis on the shores of the Adriatic sea(Encounters and dialogues among cultures),* organizuar nga revista *Shêjzat*, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, AISSEE dhe Universiteti i Zarës (Kroaci). Një tubim i tillë bëri të mundur të mblidheshin në një seli të përbashkët autoritete të kërkimit shkencor dhe të studimeve shqiptare, studiues të fushave të rëndësishme të humanitetit, përfshirë gjurmimet ballkonologjike dhe më gjerë, studimet mbi mesjetën evropiane. Morën pjesë në hapjen e këtij tubimi shkencor drejtues të Universitetit të Zarës (Kroaci) si dhe autoritete të fushës së diplomacisë mes dy vendeve tona. Konferenca e sipërcituar u përshëndet gjithashtu nga këto autoritete e pikërisht në këtë moment hyrjeje dhe iniciatorët e saj shtjelluan disa linja të rëndësishme studimore që do të reflektoheshin në kumtesat e parashikuara.

U bënë objekt trajtese në seancat përkatëse argumente të rëndësishme që prej kohësh kanë qenë objekt interesi për medievalistët, historianët, filologët, arkivistët etj.

Një trajtesë interesante që dhe shërbeu si moment hapjeje të punimeve të këtij tubimi qe ajo e mbajtur nga profesor Francesco Altimari (Universiteti i Kozencës, Kalabri), përqendruar në trajtimin e materialeve në dorëshkrim të Pietro Stankovich-it (1771-1851), si burim të dhënash për t'u gjurmuar më tej në këndvështrimin dialektor dhe gjuhësor.

U ndërmendën shkrimtarë që domosdoshmërisht koha do t'i bënte pjesë të një historie letërsie më të plotësuar e më gjithëpërfshirëse(rasti i autorit Shime Despali). Paraqitja në një këndvështrim kompleks e krahasues i shkrimtarisë së një autori si Shime Despali (Persida Asllani, Universiteti i Tiranës: The literary works of Shime Despali-memory and remembrance of a diaspora) i dha një frymë të re dhe kontekstualizimit të veprës së tij në historinë e letërsisë shqipe. Një këndvështrim të ngjashëm për nga objekti i studimit, por të përqendruar në hollësi që kishin të bënin me biografinë e këtij autori paraqiti dhe studiuesja Mirta Tomas (Universiteti i Zarës), me kumtesën me temë *The identity of Borfo Erizzo in Shime Despali's poetry*.

Nuk munguan të paraqiteshin në konferencën e Zarës trajtesa që kishin të bënin me gjurmime elementesh që përbëjnë dëshmi konkrete të pranisë së elementeve simbiotike leksikore në të folme të caktuara të shqipes (Andrey Sobolev, Universiteti i Shën Petersburgut).

Kontribute konkrete u synuan dhe në drejtim të shtjellimit me anë të të dhënash të reja të historisë së migrimeve në drejtim të Gadishullit Italik në periudha të caktuara, të rimarra në linja tashmë të shtruara nga studiues të mirënjohur në këtë fushë si Lucia Nadin, Italo Sarro, Marco Moroni. Metodologjia e trajtimit nga ana e secilit prej këtyre studiuesve bashkë me citimin e burimeve arkivore që mbeten përherë për t'u marrë në konsideratë kur trajtohen të tilla çështje në vështrimin historiografik, nënvizoi dhe një herë rëndësinë e njohjes së këtyre rrethanave të përveçme që hedhin dritë mbi historinë e dy vendeve, por dhe që ndihmojnë mjaft disiplina të tjera të përafërta studimore. Iu bashkua tubimit në Zarë dhe studiuesi i mirënjohur Josè M. Floristan (Universiteti Complutense, Madrid), i cili rimori elemente të qasjes ndaj rrethanave historike që bashkojnë popujt e Ballkanit në dritën e dokumenteve të veçanta arkivore. (An appeal of the people of Albania, Bosnia, Herzegovina, Serbia and Montenegro to the Spanish king Philip III for military help(1612-1614).

Në vazhdë të studimeve të thelluara e shumëvjeçare mbi historinë e gjurmimit të teksteve arbëreshe dhe më në veçanti të atyre që lidhen me liturgjinë dhe receptimin e episodeve gjegjëse nga ungjijtë, prof. Matteo Mandalà (Universiteti i Palermos) referoi gjerësisht mbi aspekte studimore të këtyre teksteve në botën arbëreshe dhe më gjerë.

Morën pjesë në këtë tubim dhe studiues të çështjeve me rëndësi për historinë e Shqipërisë, me trajtesa mbi aspekte të antropologjisë së studimit të të folmeve dhe zakoneve të trevave të veçanta shqiptare (Persida Lazarević di Giacomo, Universiteti i Chietit: With the people of Hormovë: the encounter of Dositej Obradović with Albania and the Albanians). Studiuesi Andi Rëmbeci (Universiteti i Tiranës) u paraqit me një studim të thelluar mbi aspekte përmbajtësore të dorëshkrimeve që përmbajnë të dhëna mbi historinë e filozofisë dhe që u përkasin shekujve të rëndësishëm për historinë e shkrimit shqip(The circulation of Enlightenment ideas in Albania during the 18th century. Three philosophical manuscripts written in Greek by Teodor Kavaljoti (1718-1789); Jorgo Sugdhuri (1645-1725); Anastas Papavasilopuli (1670-1750). Një personalitet me rëndësi për historinë e fotografisë shqiptare (Pjetër Marubi) u trajtua në bazë studimesh konkrete arkivore nga Lucian Bedeni(Muzeu Kombëtar i Fotografisë "Marubi"), pikërisht në kumtesën me titull *The journey of Pietro Marubbi from Zadar to Shkodër.*

Çështje të historisë së kishës shqiptare, por dhe të misioneve françeskane dhe domenikane në një vështrim të natyrës së mirëfilltë diakronike u trajtuan veçanërisht nga Petar Vrankić(Universiteti i Augsburgut): Croatian missionaries (Fransciscans and Dominicans)from Dalmatia and Bosnia serving in Albania from the pre-ottoman era to the present day. Evalda Paci(Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë) trajtoi në një këndvështrim të ngjashëm çështje të leximit e të rileximit të teksteve të caktuara që lidhen me historinë e kishës shqiptare e më saktë të materialeve dokumentare në format dorëshkrimi(The history of the Albanian Catholic Church in the notes of Msgr Karl Pooten. Prelates and important ecclesiastic provinces), që bëjnë të mundur përqasje me burime të afërta në kohë, por dhe të mëvona e që për më tepër kanë parë dritën e botimit.

Materiale me vlerë të veçantë e të panjohura deri më sot dhe që hedhin dritë mbi përpilime që duhen njohur e që kanë të bëjnë me variante të receptimit të katekizmit e të doktrinës së kërshtenë në viset shqitare(shekulli XIX) u paraqitën dhe u trajtuan nga prof.Ardian Ndreca(Universiteti Urbanian i Romës), në një vështrim të natyrës historiografike dhe filologjike(An unknown manuscript from the end of the 19th century in the Archive of Propaganda Fide).

Një trajtesë me interes të veçantë përbënte dhe paraqitja e studiuesit Gëzim Gurga(Universiteti i Palermos), i cili u përqendrua gjerësisht në reflektimin e neneve të kanunit shqiptar në studime e kërkime të ndryshme përfshirë ato të natyrës studimore dhe në letërsi. (Albanian consuetudinal laws in scientific research, literary fiction and media portrayal).

Reflektimi i jehonës së figurës së Gjergj Kastriotit në vëllime të veçanta epike u bë objekt trajtimi nga Z.Arben Ndreca, studiues i gjuhëve ballkanike dhe i filologjisë së teksteve sllave, një trajtesë kjo që përmbushi më tej dijen dhe të dhënat mbi figurën e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut(Scanderbeg in the Pleasant Talk of Slavic People and the immense contribute of Fr.Andrija Kacić-Miošić to the epic literature of the Southern Slavs).

Kontribute me vlerë nga hulumtues të arkivit të Venecias u paraqitën gjithashtu në këtë konferencë shkencore. Një prej tyre qe dhe ai i studiuesit Andrea Pelizza (Arkivi i Shtetit i Venecias), që bënte fjalë mbi gjeneralin italian Alberto Pariani (1876-1955) dhe arkivin e tij personal në lidhje me historinë e Shqipërisë.

Tubimit iu bashkuan ndërkohë kompozitorë dhe intrumentistë të mirënjohur që kanë kultivuar për vite të tëra muzikën shqiptare: Paolo Marzocchi, Bardh Jakova, grupi Zorja Trio etj. Koncertet e performuara në këto ditë të zhvillimit të tubimit në Zarë, pjesëmarrja dinjitoze e dy këngëtareve si Anna Stratigò dhe Maria de Filippo bënë të mundur të ndihej më afër fryma e viseve arbëreshe dhe lidhja e pashlyer me atdheun mëmë, Shqipërinë.

MARGARET ATWOOD DHE BERNARDINE EVARISTO FITUESE TË THE BOOKER PRIZE 2019





The Testaments (Testamentet)
Margaret Atwood
(Vintage, Chatto & Windus)

Më shumë se pesëmbëdhjetë vjet pas ngjarjes të "Rrefenja e shërbëtores", regjimi teokratik i Republikës Gilead është në fuqi, por ka shenja që po fillon të kalbet nga Brenda. Në këtë moment të rëndësishëm, jeta e tre grave komplet të ndryshme bashkohen me rezultate shpërthyese.

Dy janë rritur si pjesë e brezit e parë në rendin e ri. Dëshmitë e këtyre dy grave të reja janë bashkuar nga një zë i tretë: një grua që mban pushtetin përmes grumbullimit të pamëshirshëm dhe shpërndarjes së sekreteve.

Ndërsa Atwood shpalos "Testamentet", ajo shfaq veprimet me të thella të Gileadit ndërkohë që çdo grua detyrohet të pajtohet me atë që është, dhe sa larg do shkojë për atë që beson.

"Të dashur lexues: Çdo gjë që më keni pyetur mbi Gileadin dhe punët e tij të brendshme është frymëzimi për këtë libër. Epo, thuajse çdo gjë! Frymëzimi tjetër është bota ku po jetojmë."
Margaret Atwood.

Girl, Woman, Other
(Grua, Vajzë, Tjetër)
Bernardine Evaristo
(Penguin General, Hamish Hamilton)

Girl, Woman, Other ndjek jetët dhe mundet e 12 karaktereve shumë të ndryshëm. Shumica gra, me ngjyrë dhe britanike, ato tregojnë historitë e familjeve të tyre, miqve dhe të dashurve, përmes vendit dhe mes viteve.

Polifonik, i gëzueshëm, bashkëkohor dhe i gjallë, kjo është një lloj historie e re e lavdishme, një roman i kohërave tona: festiv, gjithnjë dinamik dhe krejtësisht i parezistueshëm.

Çmimet Booker

Çmimi, i cili ka nisur në 1969, ka qëllim të promovojë letërsinë më të mirë duke shpërblyer romanin më të mirë të vitit të shkruar në anglisht dhe të botuar në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë.
Për të ruajtur përsosmërinë e vazhdueshme të Çmimit Booker gjyqtarët zgjidhen nga një gamë e gjerë disiplinash, duke përfshirë kritikë, shkrimtarë, akademikë, por edhe poetë, politikanë dhe aktorë, të gjithë me pasion për letërsinë cilësore.

Fituesi i Çmimit Booker merr £50,000 dhe, ashtu si gjithë finalistët e tjerë, një çek prej £2,500 dhe një kopje të librit të tyre me lidhje speciale.

Fituesit dhe finalistët tani shijojnë gjithashtu një rritje dramatike të shitjeve të librave të tyre në të gjithë botën.

ESHTRAT QË VIJNË VONË

poezi nga Teki Dërvishi

ESHTRAT QË VIJNË VONË

prej shtëpisë sime me çati prej kashte
dola me hejben plot vegla
e mora rrugë Veriun e Thellë
kurbet me kobër dola mjeshtër me pagë
pas erës së bukës
rrugë më rrugë shkretëtirës
kah Lindja
kah Perëndimi
latues mermeri me daltë
ikonograf me brushë e ngjyrë
godita pirgjet e larta të botës
gjurmë lash shenjën e qartë
pikturat e amshuara nëpër tempuj
lirikën - fjalë të zjarrtë
aktor me pseudonim
palaço në oborrin mbretëror
pa emër pa datë
disa shekuj pastaj
në Atdhe
eshtrat më vijnë vonë
me anije
- deti çohet dallgë

VATERPOLISTI NË BULEVARD

në bulevardet me drita ngjyrë fishekzjarresh
më panë me plis të bardhë
me buzë të përvjela më thanë:
"Ja, vaterpolisti në asfalt!"
në kokë më oshëtinte
edhe porosia e sime amë
"Biro, puna fizike sjell leverdi
s'është marre të pastrosh nevojtore
ne jemi njerëz të thjeshtë
ti s'je profet
ti s'je për punë krijuese, për lavdi
për punë hyjnore... shpirtërore
nëpër zebrën e kalimtarëve asfaltit ngarendi
e ngreh përdore kazanin me rrotë
mbi një teneqe me prush
në skarë pjek shtalba misri
dimrit pjek gështenja
në Pragë Paris e Stamboll
vjeshtë e dimër
erë bliri kundërmoj
erë vere nga atdheu im
më sjellin kanjushat e mërgimtarëve
të pështjellë me letër-celofan

TRIM I MARRË

në trotuar si beduin si kloshar
në rrugët e botës më zë natë
ngrysem si çifteli e kërleshur
vruga qepallave hije m'i bën
lirë e shes artin tim - mjeshtërinë
se bukën s'e dua lëmoshë
mëshirë s'e dua dashurinë
asnjë bar nostalgjinë s'ma shëron
re e mllefur në ballin tim
vetëton e bubullon
më vret dru të njomë
vonesa ime pranverore
do të kthjellet në paanësi e di
në veri atje ku një Doruntinë
psherëtin
e vëlla më pret t'i vij
malli për të boll më del
me leckat e mia vjeshta
rrugëve të planetit kah m'i vjel

PLOJA E NATËS NË DEÇAN

Pas ushtarëve.
erdhën ikonografët me brusha,
për të pikturuar "Pamjen" që paraqet një vajzë shtatëvjeçare.
duke qëndruar në këmbë,
në këmishë nate,
në terrin e dhomës,
midis trupave të masakruar të prindërve,
vëllezërve dhe motrave të saj.

Cili terr i mesnatës mund të paraqitet në pikturë
Pa hijen e domosdoshme të dritave diskrete
Edhe dhomës i mungon dritarja edhe qiellit yjet
Kur ata që shohin me sytë tanë, tashmë janë të vdekur.
Ata janë në paqe me vetveten: as afër s'janë. as larg
Një dritë mendimi mund të bëjë tufë spektri violet
Aq sa ta paraqesë figurën vertikale të Hanës shtatëvjeçare
Merrni me mend dritat që i japin pamjet e ëndrrës
Në të cilën ju vret me thikë pas shpine ulurima e shtazës.
Piktura t'përjetëson n'këmbë duke qëndruar njëmijë vjet
E rrethuar nga trupat e prindërve të saj të masakruar
Me cilat këmbë do të largohet ajo hapësirës pa horizont
Shkallëve tatëpjetë si do t'i kapërcejë lumenjtë aheron.
Cila ulkonjë e pyllit të egër do t'i japë sisë
Me ç'gjuhë do t'i flasë Liria kur ajo t'i zbret nga mali
Në qytetin e dritave kristale, yje të natës në verë
Gjuha e tmerrit, gjuha e vetmisë, gjuha e kobit të zi
Është heshtja e t'masakruarve që ikin në sferat e tjera.
Kaq shihet piktura me dritën e mendjes shumë statike
Thotë Profeti i Xhibranit, "kur ri nuk banon në tmerr
atëherë jeton me gojë, me fjalë. Zëri të bëhet lojë"
Pamja e masakrës në kafazin e fjalëve krahët i hap
por nuk mund të fluturojë atje ku janë të vdekurit tonë
Po vijnë sharlatanët, politikanët,
vëzhguesit, monitorët, humanitarë, mjekët pa kufij,
zyrtarët e Bashkësisë Evropiane, rusët dhe kriminelët e tjerë.
Nuk i la policia piktorët, kompozitorët,
poetët, profetët – që të hyjnë në Banesën e Hanës shtatëvjeçare,
ta pikturojnë duke qëndruar në këmbë pranë kufomave të prindërve të saj të masakruar.

DITA E PARË E VERËS '98

Në çdo fund të vitit shkollor të fëmijërisë sime
Kanë munguar nxënësit që janë mbytur në Lumin e thellë
Unë siç shihni ende jam gjallë. E prita edhe këtë verë
Në këtë fund të vitit shkollor mungojnë disa arsimtarë
Tashmë janë tharë. Ra zilja e mbramë. Të gjithë pse qajnë?
Unë dal oborrit të shkollës mbuluar me barin e njomë
Jo nata që më zë në atë rrugë deri te dera kah largohem
Më zë mosha ime. Pikëllimi. Kori me këngën për dëshmorë
pse s'kanë lozur fëmijët - barin e njomë ta shkelin oborrit?
Ata s'duan më të jenë lojtarë, por ushtarë të UÇK-së
Buza e tyre e njomë me shkrumbin e dhembjes i fotografon
Kanë shenjë Saturni. Nëse arrijnë të plaken, vdesin të njomë!
Si luftoj unë që mendoj se fjalët ta hanë kokën shqim?
Unë nuk kam kujdes kur flas. Gjuha m'shtin në flakë
Kur shkruaj unë nuk flas, dikush me pëshpërit në vesh
Mos u frikëso! Futu në zjarr! Mos u sill rrotull zjarrit!
Mos e aktro dhembjen! Mos e aktro vetminë! Mos u shtir!
Por fjalët e rrezikshme ende nuk më vranë. Jam gjallë
Kush mund të më besojë? Kush beson se ka trima të gjallë?
Një herë ndodh çdo gjë! Të tjerët ta përsërisin fatin!
Unë ia dal të mendoj: nëse vazhdojnë t'i vrasin fëmijët
Ç't'i them moshës sime? Të ngushëllohem me fjalë t'rrezikshme
Të hyj në flakë me fjalët trime, apo me trupin tim - me kokë?
Kush thotë e jap kokën për Atdhe, gjuha i flet n'gojë e gjallë
Heronjtë s'flasin, veç kur m'i përshpërisin në vesh këto fjalë!
Ra zilja e mbramë. Fëmijë të vdekur mungojnë. Mungojnë arsimtarë
Lumi i Thellë i fëmijërisë sime i merr, apo Mali në Veriun e Thellë
Çdo gjë është vjetruar. Çdo gjë që përsëritet. Vetëm fëmijët tanë
Dhe, varret e gjyshërve - habiten si nuk na ka hije mosha jonë!
Nëse keni duruar robërinë, na lini neve rrugë kah parajsa, thonë.

(Me rastin e tetë vjetorit të shkuarjes në amshim të shkrimtarit Teki Dërvishi)
Nëse në Britani ekziston si model katedra e Shekspirologjisë, e pakta që mund të bëhet në sistemin tonë arsimor, kulturor e mediatik, është përfshirja si objekt studimi i veprës së Teki Dërvishit, njërit prej kodifikuesve të rrallë të shenjëzimit letrar, duke filluar që nga tregimet e para të botuara në revistën 'Jeta e re', në fillim të viteve 60, që drejtohej nga Esad Mekuli, ku bënte pjesë edhe tregimi 'Sania' , e deri te krijimet fundit, të shpërndara nëpër gazeta e revista në dhjetëvjetëshin e fundit para se të ndërronte jetë, më 29 qetshor 2011.



TEKI DERVISHI, NJË SHKOLLË E NXËNË JASHTË LIBRAVE

Nga Emin AZEMI

Të gjithë studiuesit e letërsisë, por edhe lexuesit e vëmendshëm të veprës së Teki Dërvishit, janë shoqëruar me jo pak dilema para se t'iu kenë qasur këtij shkrimtari, sa origjinal,po aq edhe kompleks, sa modernist, po aq edhe eksperimental. Teki Dërvishi është ndër shkrimtarët e rrallë të letërsisë sonë që ka mbetur jo vetëm i pastudiuar, por për rrjedhojë, statusi i tij si individualitet krijues nuk e ka zënë vendin e merituar në sistemin e përgjithshëm valorizues të universit tonë letrar, por edhe në njohjen e meritave që ai pati në mbajtjen gjallë të rezistencës intelektuale e protestës krijuese kundrejt sistemeve antikombëtare e akulturuese.

Teki Dërvishi erdhi si fenomen krijues dhe mbetet i tillë për shumë arsye, sepse ai nuk ishte shkrimtar mode, ndonëse nuk ishte demode, ai nuk shkroi që t'i përshtatet kohës, ndonëse nuk ishte jashtë kohe, ai nuk i takonte oborrit letrar, por vepra e tij theu shumë gardhiqe që i kishte vendosur kritika zyrtare dhe fryma letrare e poltronëve oborrtarë…

Në vitin 1981 Teki Dërvishin e larguan nga gazeta 'Flaka e Vëllazërimit', sepse refuzoi të shkruante kundër Ismail Kadaresë, që i bie se ai refuzoi të del kundër vetvetes dhe po të vepronte ndryshe ai nuk do të ishte më Teki Dërvishi. Ishte po ai që i takonte Grupit të Demaçit, si përfaqësues i Rrafshit të Dukagjinit dhe i dënuar si 17 vjeçar me burg të rëndë në ishullin famkeq të Goli Otokut, , që njihej si Alkatrazi i Jugosllavisë së atëhershme, ku vuajtën dënime shumë disidentë të kohës. Kjo ishte edhe një shkollë për T. Dërvishin të cilën ai kishte arritur ta nxëjë jashtë librave, që më vonë ai vet do të bëhej një shkollë për të tjerët e nxënë jashtë librave, por edhe një aksiomë jetësore që e kishte mësuar nga Dush Kusari që 'kurrë të mos i takonte shumicës'. Ishte po ai i cili veproi gjithmonë sipas dellit të krijuesit e njeriut vertikal që udhën e nisur e përfundonte atje ku i thoshte ndërgjegjja.

Dhe ndërgjegjja e Teki Dërvishit ishte baraz me fuqinë krijuese për t'i bërë një radiografi poetike shtëpisë së sëmurë, e cila po lëngonte mbi gërmadhat e një ngrehine qe herët a vonë duhej rrënuar, por, edhe si i varun me vargje për drurin e blertë, ai arriti ta ruajë pastërtinë e poezisë nga klishetë e socrealizmit dhe skemave të mërzitshme të një letërsie me patos social dhe me avangardizëm të shpifur. (me vëllimet poetike Nimfa 1970, I Varun me Vargje për drunin e blertë 1971, Shtëpia e Sëmurë 1978, Thashë 1981. Ai, madje, siç do të vëjë në dukje njëri prej njohësve më të spikatur të veprës së këtij shkrimtari, prof. Nehas Sopaj, sipas të cilit Teki Dërvishi jo vetëm që ishte kompleks për nga natyra dhe veçantia e shkrimit, por edhe për faktin se "ai, krahas Marin Camajt dhe Beqir Musliut ,në letërsinë tonë bashkëkohore është një ndër shkrimtarët më produktivë dhe vepra e tij shënon shkollë shkrimi më vete ku autorin e shohim shumë pjellor duke lëruar tri gjinitë letrare paralelisht: poezi, prozë dhe dramë dhe është vështirë të kuptohet pesha dhe rëndësia e veprës së tij nëse lexohet parcialisht, pra nëse lexohet vetëm si poet, si prozator apo si dramaturg. Por, edhe të lexuarit në tërësi të veprës së tij është i vështirë, sepse problem numër një për receptim paraqet mosnjohja e domosdoshme e kodeve të shkrimit të autorit".

Të rrallë janë shkrimtarët në letërsinë tonë që sistemin e ideve dhe konceptin estetik e kishin të mishëruar si një tërësi në vetë natyrën e krijimit, ose siç do të shprehet një studiues tjetër meritor i veprës së Teki Dërvishit, Ramadan Musliu sipas të cilit "Teki Dërvishi arriti të krijojë një opus letrar në të cilin hetohet një sistem idesh, një koncept unik estetik, një vetëdije krijuese, e cila kur vështrohet në të gjitha planet, del si një artist në rolin e demiurgut, ai që arrin të krijojë një univers artistik".

Brezi i shkrimtarëve që erdhi bashkë me Teki Dërvishin, siç ishin Beqir Musliu, Musa Ramadani, Ymer Shkreli, Xhabir Ahmeti, Resul Shabani, Nexhmedin Soba e ndonjë tjetër, ishte fryma që po thyente një traditë shkrimi, por edhe brezi i shkrimtarëve që arritën të bëjnë kalime të pahetueshme nga zhanri në zhanër duke qenë të suksesshëm në çdo njërin prej tyre.

I tillë ishte edhe Teki Dërvishi, i cili madje edhe kur shkruante prozë, shkrinte elemente të tjera të natyrës shkrimore, (duke filluar nga vëllimi me tregime 'Etje dhe borë') dhe siç do të vërejë edhe studiuesi Ibrahim Rugova teksa analizonte romanin 'Pirgu i lartë' që e konsideronte një prurje të re në letërsinë shqipe për kohën kur u botua (1972) , sidomos sa i përket funksionit të poezisë në roman. Kjo strukturë novatore e të rrëfyerit mbase do ta bëjë 'Pirgun e lartë' romanin e parë lirik në letërsinë shqipe, për të vazhduar me një tjetër observim narrativ përmes romanit 'Herezia e Dërvish Mallutës", në të cilin Teki Dërvishi tematizon herezinë e raportit në mes të individit dhe rrethit dhe



thellësinë e paradoksalitetit të keqkuptimeve në këto raporte, ku Dervish Malluta prish kanonet të cilave është dashur t'iu përmbahet.

Se Teki Dërvishi është një shkrimtar që kapërcimin e fakturës shkrimore nga një zhanër në zhanrin tjetër e bën me sukses, por edhe me pasion eksperimental, pa rënë në grackën e eklektizmit të tepruar stilistik, dëshmon edhe përkushtimi i tij ndaj dramaturgjisë, që dikush prej miqve dhe krijuesve e pat quajtur 'Shekspiri shqiptar', përmes dramave: Zbutësi i njerëzve me sy prej zymrydi, Bregu i Pikëllimit, Pranvera e Librave, Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit, Kufiri me atdhe, Mbreti i lirë, Vojceku, Eshtrat që vinë vonë, Nesër nisemi për Parajsë, 1999, Ku është Populli?.

Në gjithë këtë opus dramatik, ai kulmin e arriti me 'Bregu i pikëllimit', një cikël prej nëntë njësish dramaturgjike, të cilat edhe po të lexohen dhe të luhen veç e veç, mund të funksionojnë si mëvetësi kuptimore, pa e prishur tërësinë e integralitetit, ndonëse në skenat e Teatrit, sidomos realizimi në Teatrin Kombëtar të Prishtinës, me regjisorin Vladimir Milçin, Bregu i Pikëllimit, jo vetëm që po e freskonte tempullin e Talisë me një prurje tepër të komplekse e të guximshme, por po i jepte Teatrit shqiptar një ritëm të ri zhvillimi, një dinamikë që kishte filluar ta humbë në kohën kur kjo dramë u vu në skenën e Prishtinës në fillim të nëntëdhjetave. Përmes Bregut të pikëllimit Teki Dërsvishi bëri konfigurimin skenik të një udhëtimi të dyzuar mitik e real të njeriut, i cili , siç ndodhte edhe me Itakën e Odisës, ashtu Suka e Cërmjanit ishte për Udhësin Lojëtar sizmologjia e gjendjeve shpirtërore, që duhej të kalonte nëpër nëntë rrathë, që ishin nëntë shtresa të sprovës njerëzore, por edhe nëntë hallka të vetëpërcaktimit moral të individit në kontekst të xhunglës sociale e psikologjike që e rrethonte.

Teki Dërvishi erudit e shkrimtar, estet e publicist, eksperimentues e postmodernist, i cili kurrë nuk parapëlqeu t'i takonte shumicës, mbetet pengu më i madh i i një misioni të papërfunduar i botuesve, studiuesve e përgjithësisht lexuesve, sepse njohja më cilësore me këtë shkrimtar tash e në të ardhmen nuk mund të bëhet pa një ridefinim të statusit të tij në letrat tona dhe kjo uk mund të bëhet pa u botuar e plotë vepra e tij, në poezi, prozë, dramë, ese, kritikë (letrare dhe teatrore), publicistikë, dhe pa u studiuar me themel sistemi estetik e shkrimor i kësaj vepre.

Nëse në Britani ekziston si model katedra e Shekspirologjisë, e pakta që mund të bëhet në sistemin tonë arsimor, kulturor e mediatik, është përfshirja si objekt studimi i veprës së Teki Dërvishit, njërit prej kodifikuesve të rrallë të shenjëzimit letrar, duke filluar që nga tregimet e para të botuara në revistën 'Jeta e re', në fillim të viteve 60, që drejtohej nga Esad Mekuli, ku bënte pjesë edhe tregimi 'Sania' , e deri te krijimet fundit, të shpërndara nëpër gazeta e revista në dhjetëvjetëshin e fundit para se të ndërronte jetë, më 29 qetshor 2011.

Kritiku i mirënjohur amerikan, ndahet nga jeta në moshën 89 vjeçare

Harold Bloom

Si dhe përse të lexojmë

Leximi nuk duhet reshtur kurrë, sepse ai ka rëndësi të dorës së parë, për ta mbajtur sadopak gjallë aftësinë e formimit të gjykimit dhe mendimeve vetjake. Mënyra se si lexohet, mirë a keq, nuk mund varet vetëm prej nesh, porse arsyeja përse lexohet duhet me qenë vetëm e vetëm në shërbim të interesit tonë. Mund të lexohet thjesht për të vrarë kohën, sikurse mund te lexohet i yshtur prej një nevoje të thellë të brendshme, në një rast të këtillë, ka për të mbërritë më së mbrami ai çasti i pangishëm kur leximi do të ta bëj natën ditë. Lexonjësit e Biblës, ata që përpiqen me gjetë biblën e vetvetes, ndoshta e trupëzojnë këtë nevojë të brendshme shumë më mirë se lexuesit e Shekspirit, porse në të dyja rastet, prapëseprap, grishja është po ajo. Një nga shërbimet e të lexuarit, është të na përgatisë për ndryshimin tonë, dhe ndryshimi më i fundmë, ajme, është universal.

Mua leximi më shëmbëllen me një ritual vetmitar, më shumë se me një mision edukues. Mënyra se si lexojmë sot, kur jemi vetëm me veten tonë, përbën deri diku një vazhdimësi të leximit në të shkuarën, sidoqë sot leximi interpretohet nëpër akademi. Lexuesi im ideal (sikurse heroi im i përjetshëm) është Dr. Samuel Johnson-i, i cili ishte i vetëdijshëm për të dyja, fuqinë dhe pamundësinë e të lexuarit pareshtur. Sikurse çdo aktivitet tjetër i mendjes, ai duhet të përmbush parimin e parë të Johnson-it, leximin e asaj "çka na përshtatet më së miri, çka na sjell dobi." Sër Francis Bacon, përhapësi i disa prej ideve që Johnson-i vuri në jetë, pat dhënë një këshillë shumë të vyer "Lexo duke ruajtur gjykimin, pa t'u bërë trutë dhallë, duke mos besuar gjithçka mendjen pa e vrarë, jo për të rrahur ujë në havan me fjalë që s'kanë mbarim, por duke i dhënë peshë mendimit, duke u thelluar në gjykim." Unë do të vija përkrah Bacon-it dhe Johnsonit, një tjetër mendimtar të urtë, Emersonin, të ashprin armik të historisë dhe historicizmave të çdo lloji, i cili pat theksuar se librat më të mirë "na trondisin me bindjen e thellë, se ajo nevojë e brendshme që shkruan, po ajo lexon."

Lejomëni atëherë të bëj njësh thëniet e Bacon-it, Johnson-it, edhe Emerson-it, për të përftuar një formulë të vetme se si të lexojmë: lexo çka më së miri të përshtatet, çka të sjell dobi, libra që i japin peshë mendimit duke të thelluar në gjykim, libra që të trondisin ngase keni të njëjtën natyrë, të pacënuar nga e tirani e kohës. Pikë për pikë, kjo do të thotë, në fillim gjejeni ju Shekspirin, mandej lëreni t'ju gjej. Nëse leximi i Mbreti Lir,ju rrëmben të tërin, atëherë mendoni e gjykoni për natyrën e njëjtë që personazhi ndan me ju; afrinë me veten tënde. Vetëmse këtë s'e shoh asfare si idealizëm por si pragmatizëm. Ta gjykosh këtë tragjedi si akuzë kundër sistemit patriarkal do të thotë të heqësh dorë nga interesat e tua më vetjake, sidomos kur kemi të bëjmë me lexuese, çka është më ironike se sa duket. Shakespeare, më shumë se sa Sophocles, përbën një autoritet të padiskutueshëm dhe të pashmangshëm për sa i përket konfliktit ndërmjet brezave, dhe më shumë se kushdo tjetër, në lidhje me ndryshimet ndërmjet grave dhe burrave. Jini të hapur kundrejt një leximi të shumëanshëm të Mbreti Lir, dhe kësisoj do të kuptoni shumë më mirë origjinën e asaj çka ju e quani patriarkat.

Në fund të fundit - ne lexojmë - sikurse Bacon-i, Johnson-i, dhe Emerson-i do të ishin të një mendjeje - për të forcuar unin tonë, për të mësuar interesat e tij të qenësishme. Leximi na trand së brendshmi duke na dhënë ndiesi të atilla kënaqësie të cilat shpjegojnë deri diku se përse vlerat estetike janë nënvlerësuar nga moralistët socialë, qysh prej Platonit deri tek kampi i sotshëm i puritanëve. Kënaqësitë leximore janë në të vërtetë egoiste më shumë se sociale. Nuk është se përmirësohet drejtpërdrejt jeta e ndokujt nëse leximi është më i mirë e më i thellë. Mbetem mosbesues ndaj shpresës tradicionale sociale se kujdesi ndaj të tjerëve mund të nxitet prej gjallërimit të imagjinatës vetjake, sikurse jam i tejnginjur me argumentat e gjertanishme që përqasin ëndjet e leximit vetmitar me të mirën publike.

Ajo çka është e trishtueshme sa i përket leximit në mënyrë profesionale është fakti se rrallë ndodh të ndiesh sërish atë mrekullim të dikurshëm që të ngjallte leximi në rini, atëkohë kur librat mbartnin "mrekullimin hazlitian". Mënyra se si lexojmë sot, varet deri diku apo plotësisht nga largësia, qoftë kjo e brendshme apo e jashtme, që ne vendosim në lidhje me universitetet, vendet ku leximi rrallë mësohet si kënaqësi, në kuptimin më të thellë të estetikës së kënaqësisë. Hapja e vetvetes kundrejt një përballjeje të drejtpërdrejtë me Shekspirin në kulmin e fuqisë së tij krijuese, sikurse është Mbreti Lir, asnjëherë nuk është e lehtë, në të ri sikurse në pleqëri, dhe prapëseprapë të mos e lexosh në plotninë e vet Mbretit Lir (çka do të thotë pa kurrfarë manteli ideologjik) do të thotë të mashtrosh botërisht vetveten edhe në gjykim edhe estetikisht. Një fëmijëri ku pjesën më të madhe të kohës e zë televizori domosdo shpie tek një adoleshencë ku kohën e gllabëron kompjuteri, dhe kësisoj në dyert e univesitetit kemi një student që s'ka gjasa ta mirëpresë idenë se nevojitet durim në këtë rrugëtim që s'njeh fund deri në cakun e mbramë: urtinë që është gjithçka. Shmangia e këtij rrugëtimi e

bjerr aftësinë e leximit, sikurse vetë unin bashkë me të. Keqardhja në këso rastesh s'ka kurrfarë vlere ashtu si zotimet e programet e paskëtajshme të leximit. Gjithçka ende mund të ndryshohet, mund të bëhet prej një lloj elite, gjë në në fakt është e papranueshme, për shumë arsye, të mira e të këqija bashkë. Kjo ngase edhe sot ka akoma lexues vetmitarë, të rinj e të vjetër, kudo, madje edhe në universitete. Nëse kritika shërben për ndofarë gjëje ende në kohën tonë, shërben sepse i drejtohet këtij lexuesi, lexuesi që lexon për vetveten, dhe jo për interesa që me gjasë e tejkalojnë vetveten.

Vlera në letërsi sikurse në jetë, më së shumti ka të bëjë me të veçantën fshehatare, atë që kalon cakun e të zakonshmes, të tepërtën prej së cilës merr jetë kuptimi. Nuk është rastësi që historiografët - kritikët që besojnë se njerëzit janë produkt i historisë shoqërore - i shohin personazhet letrarë thjesht si gjurmë të lëna në letër, dhe kaq. Hamleti as që përbën një të vërtetë historike nëse mendimet që kemi nuk na përkasin ne. Kjo na sjell tek parimi i parë, që mund të përmirësojë mënyrën se si lexojmë sot, parim që ja detyroj Dr. Johnson-it: "Çliroje mendjen prej klisheve" Fjalori të dëften që klisheja është ligjërim i stërfyrë me banalitete të rëndomta, fjalor i stërçuditshëm si ai i një sekti a kulti shtriganësh.

Meqënese universitetet kanë fuqizuar kulte të tilla si "gjinia dhe seksualiteti" dhe "multikulutarizmi," qortimi i Johnson-it kësisoj shndërrohet në "çliroje mendjen nga kilshetë akademike." Një kulturë universitare që vlerëson më shumë të brendshmet e femrave të periudhës viktoriane se sa vlerëson Çarls Dikensin dhe Robert Browning-un i ngjan një dalldie si ato që përshkruan Nathaniel West-i, gjë që tashmë është kthyer në as më shumë dhe as më pak se në standart. Produkt anësor i një "kulture poetike" të këtillë është fakti se nuk arrin të nxjerrë as edhe një Nathaniel West, dhe as nuk e degdis qoftë edhe ky fakt një kulturë akdemikë të allasojtë në zgripin e parodisë? Poemat e një mjedisi të kësoshëm akademik janë zëvendësuar nga të brendshmet e kulturës sonë. Materialistët tanë riosh na dëftejnë se i kanë kthyer trupin historiografisë, dhe shpallin se punojnë në emër të Parimit të Realitetit. Jeta e mendjes duhet të mposhtë vdekjen e trupit, por prapësperapë kjo as që ka nevojë për bujën zulmëmadhe të një sekti akademik.

Parimi i çlirimit të mendjes prej klisheve na shpie tek parimi i dytë i ringjalljes së leximit: Mos u orvat të bësh më të mirë fqinjin apo lagjen me atë që lexon apo si e lexon. Vetëpërmirësimi është një projekt aq madhor sa të mjafton vetja, mendja dhe shpirti yt: për to s'ka kurrfarë etike leximi. Mendja duhet mbajtur e përqendruar në shtëpinë tënde derisa padituria e saj e mirëfilltë të jetë zbuar me gjithsej; angazhimi i parakohshëm është magjepsës në vetvete, por merr shumë kohë, kohë e cila për leximin nuk do të jetë e mjaftueshme kurrë. Shkrimi për historinë, qoftë ajo e tashme apo e shkuar, është një lloj idhujtarie, adhurim i vazhdueshëm për çka ndodh në kohë. Lexo atëherë i udhëhequr prej dritës së brendshme që kremtonte Xhon Miltoni dhe që Emersoni e kishte parim të leximit, parim që fare mire mund të jeti parimi ynë i tretë: Studiuesi është një qiri që ndizet gjithmonë prej dashurisë dhe gjakimeve të njerëzimit. Wallace Stevens-i, ndoshta duke e harruar autorin e tij, krijoi variante të mahnitshme të kësaj metafore, por fjalët burimore Emersoniane përbën një shprehje më të qartë të parimit të tretë të leximit. Nuk ka vend për drojen se liria e përmirësimit tënd si lexues përbën egoizëm, sepse nëse arrin të bëhesh lexues i mirëfilltë, atëherë fryti i mundimeve të tua do të shndërroj në një mendjendriçues për të tjerët.

U jam rikthyer shumë herë letrave që kam marrë prej njerëzish të panjohur tetë a nëntë vitet e fundit, dhe më ka ndodhur shpesh të prekem aq shumë prej tyre sa të mos mundem t'u kthej përgjigje. Pathosi që i përshkon, për mendimin tim, përbën më së shumti një nevojë të thellë për studimin letrar profesionist, detyrim që universitet nuk begenisin ta përmbushin. Emersoni ka shkruar se shoqëria nuk bën dot pa njerëz të kultivuar dhe shtoi në mënyrë profetike se: "vatra e shkrimtarit nuk është shkolla, por njerëzimi." Ai e

kishte fjalën për shkrimtarë të fuqishëm, burra dhe gra që merrnin përsipër të ishin përfaqësues, përfaqësues të vetvetes, dhe jo kushtetutave, me të vetmen politikë atë që buron prej shpirtit njerëzor.

Funksioni më i lënë pas dore i edukimit universitar është nyjëtuar përjetësisht në thirrjen e Emersonit drejtuar "Studiuesit amerikan", ku ai shpall se detyrat e studiuesit: "Mund të përmblidhen të gjitha tek vetëbesimi." Unë marr nga Emersoni edhe parimin e katërt të leximit: Që te lexosh mirë duhet të kesh shpirt krijues. "Leximin krijues" në kuptimin Emersonian e kam quajtur një herë "keqlexim," fjalë që i bindi kundërshtarët e mi se vuaja nga disleksia kronike. Humbëtira apo zbrazëti që ata shohin pas leximit të një poeme është pasojë e mospasjes së një shpirti të tillë krijues. Vetëbesimi nuk është dhunti, por Rilindja e Dytë e mendjes, e cila nuk mund të ndodhë pa vite të tëra leximi të pareshtur. Estetika nuk ka standarte absolute. Nëse ndokush mëton se fuqia shekspiriane është produkt i kolonializmit ateherë kush po e vriska mendjen të argumentoj të kundërtën? Pas katër shekujsh Shekspiri është më i fuqishëm se kurrë; dramat e tij do të luhen në hapësira jashtëtokësore, në të tjera botë, nëse këto botë do të arrihen. Ai nuk përbën përbetim për kulturën Perëndimore; por mishëron të gjitha parimet e leximit dhe është pika ime e referimit në këtë libër.

Borgesi ia mvishte këtë universalizëm mungesës së mirëfilltë të egoizmit të tij, cilësi që përbën një metaforë të shumëfishtë për dallimin mes Shakespear-it dhe të tjerëve, metaforë e fuqisë së tij njohëse si e tillë. Ne lexojmë, më shpesh e më shumë se sa ne mendojmë se lexojmë, në kërkim të një mendjeje më origjinale se e jona.

Ideologjia, sidomos në variantet me të cekëta të saj, është rrënuese sa i përket aftësisë së të kuptuarit dhe vlerësimit të ironisë, ngase unë sugjeroj që ringjallja e ironisë të jetë parimi ynë i pestë i ripërtëritjes së leximit.

Mendoni ironinë e pafundme të Hamlet-it, i cili kur thotë diçka nënkupton kryekrejet diç tjetër, më së shumti krejt të kundërt me atë që thotë. Por, ky parim, sikur ma vret shpirtin, prejse s'ka gjasa t'i mësosh dikujt të jetë ironik sikurse të bëhet lexues vetmitar. Prapëseprapë, humbja e ironisë shënon vdekjen e leximit, të asaj çka përbën qytetërim në mendjet tona.

U qasa çap pas çapi fare lehtë
Ngadalë e mata udhën ca nga ca
Yjet mbi Krye flakëruan hatâ
Nën këmbë kisha Detin vetë

S'dija se ç'ndillte tjetri hap
Mos vallë i fundmi asisoj -
Cakun e preka prapëseprap
Disa e quajnë "Përvojë"

Të ecurit e burrave është e ndryshme nga e grave, me përjashtim të rastit kur janë në kuadrate të disiplinuara marshimi, pasi ne të gjithë përpiqemi të ecim ndryshe nga të tjerët. Dickinson-i, mjeshtrja e Sublimes në zgrip, zor se mund të kuptohet nëse nuk ndiejmë shqisën e ironisë së saj. Ajo ecën përgjatë të vetmes udhë të mundshme, "çap pas çapi" por çapitja e saj e dalëngadaltë pranëvihet në mënyre ironike me nje titanizëm ku ajo ndien "Yjet mbi Krye," ndërkohë që ka detin nën këmbë. Duke mos e ditur nëse hapi tjetër i saj do të jetë "i fundmi asisoj" kjo i jep asaj atë mbërritje në atë cak të mbramë që ajo nuk do t'i vër emër, porse vetëm thotë që "disa" e quajnë Përvojë.

Ajo e kishte lexuar esenë e Emersonit "Përvoja", një punë e shkëlqyer në gjurmët e esesë "Mbi përvojën" shkruar prej mjeshtrit të saj Montaigne, dhe ironia e saj është një përgjigje e përkorë ndaj fjalëve hyrëse të Emersonit "Ku ta gjejmë vetveten? Një përgjigje kundrejt një numri pyetjesh që nuk njohin cak, sepse besohet se ato nuk ekzistojnë." Caku për Dickinson-in është të mosditurit nëse tjetri hap është i fundmi asisoj. "Nëse ndokush prej nesh do ta dinte se si do ta kishim të shkuarën dhe cili është fati ynë i ardhshëm, atëherë kjo do të ishte kulmi i dijes!" Rugëtimi i mëpasshëm i Emersonit ndryshon nga ritmi i shtruar i Dkinsonit, sikurse e thotë ajo, "çap pas çapi". "Gjithçka rrjedh dhe shndrit,"në mbretërinë e përvojës së Emersonit, dhe ironija e tij gjeniale është krejt ndryshe nga ironia e saj e nëndheshme. E megjithatë, asnjëri sosh nuk është ideolog dhe të dy mbijetojnë në kohë sajë fuqisë që mbartin ironitë e tyre të kundërta.

Në fund të shtegut të ironisë së humbur është caku i mbramë, përtej të cilit vlera e letërsisë do të jetë e paripërtërishme. Ironia është thjesht një metaforë, dhe rrallë ndodh që ironia e një epoke letrare të jetë si ajo e një epoke tjetër, sidoqoftë, pa rilindjen e kuptimit të ironisë humbet shumë më shumë se ajo që ne e quajmë shkrim letrar. Tomas Mani, ndër më ironikët e shkrimtarëve të këtij shekulli, duket se është bër fir tashmë. Botohen biografi të reja të tij, dhe shkrimet për to mbështeten pothuajse gjithmonë vetëm në homoseksualitetin e tij, a thua se kësisoj do mbahet gjallë interesi ynë si lexues për to, vetëm nëse vërtetohet së ishte homoseksual, dhe kjo t'i sigurojë një vend në bibliotekat tona. Nuk ndodh ndryshe as kur bëhet fjalë për Shekspirin, më së shumti përmendet biseksualiteti i tij i dallueshëm, dhe kësisoj huqet e puritanëve të kohës sonë nuk kanë të sosur. Ironitë shekspiriane, sikurse dihet, jamë më të shumëkuptimshmet dhe dialektiket



në tërë letërsinë perëndimore, dhe prapëseprap ato nuk ndërmjetësojnë gjithmonë pasionet e personazheve të tij për ne, kaq e gjerë dhe e fuqishme është furtuna e tyre emocionale. Kjo është arsyeja pse Shakespeare e tejkalon epokën tonë, edhe pse ironitë e tij shpërfillen për t'u marrë me vogëlsira.

Nga ana tjetër, në çdo emocion që ngjall Tomas Mani, rrëfimor apo dramatik, ai ndërmjetësohet prej një estetike të ironisë; dhe ajo nuk mund t'u mësohet si e tillë e shembullzuar tek librat Vdekje në Venecie ose Pështjellim dhe pikëllim i kahershëm pasi për shumë prej studentëve, qoftë edhe për më të talentuarit, është pothuajse e pamundur. Kur autorët rrënohen prej historisë, ne me të drejtë i shohim veprat e tyre si trakate periudhash historike, por kur ato nuk mbijetojnë për shkak të idelogjisë historike që i përshkon, mendoj se kemi të bëjmë me një dukuri tjetër.

Ironia kërkon një vëmendje të caktuar, sikurse aftësinë për të ngjallur ide kundërthënëse, edhe kur ato ndeshen me njëra-tjetrën. Po ti heqim ironinë leximit, i kemi hequr të befasishmen, gjithë të papriturën që na grish. Rrokni çfarëdo lloj libri që t'u zërë dora, një nga ata me vlera që gjykohen e peshohen, dhe keni për të parë se ka shumë gjasa që ironia do të jetë ajo që i jep vlerë e peshë, paçka se shumë prej mësuesve tuaj nuk e dinë se çfarë është apo se ku duhet kërkuar ajo. Ironia ta qëron mendjen prej klisheve ideologjike dhe të ndih të bësh dritë si qiriri i studiuesit.

Tani po kaptoj të shtatëdhjetat, dhe në këtë moshë njeriu nuk para ka qejf të lexojë letërsi të dobët sikurse të shohë ditë të zeza, përderisa ditët i kemi të numëruara. Nuk e di nëse vdekjen ia kemi borxh Zotit a natyrës, por natyra do të bëjë të vetën, dhe ne pa më të voglin dyshim mediokritetit nuk i kemi kurrfarë borxhi, pavarësisht se çfarë turme nënkupton apo përfaqëson ai. Ngase lexuesi im ideal, për një gjysmë shekullia, ka qenë Dr. Samuel Johnson-i, po sjell fragmentin tim të parapëlqyer shkëputur nga parathënia e tij për Shakespeare-in:

Kjo pra është fuqia e Shakespeare-it, drama e tij është pasqyrë e jetës; kushdo që kuturis në mbretërinë e imagjinatës për të rendur pas shajnive që të tjerë shkrimtarë para tij krijuan, mund të gjej tek ai ilaçin shërues për dallditë e tij delirante ngase lexon aty ndenjat njerëzore në gjuhë njerëzore, prej skenash me anë të cilave një eremit mund të shkoqisë punët e botës dhe një pendestar shtigjet e pasioneve të saj."

Që të lexosh ndjenjat njerëzore në gjuhën me të cilën shprehen, duhet të dish të kuptosh gjuhën njerëzore, në plotninë e saj. Kështu ti i tejkalon ideologjitë, pavarësisht nga bindjet vetjake që mund të kesh, dhe Shakespeare shfaqet para teje, sipas aftësisë që zotëron për ta zbuluar atë. Kjo do të thotë se Shakespeare të lexon më katërcipërisht se sa mund ta lexosh ti atë, edhe kur ta kesh qëruar mendjen nga klishetë. Asnjë shkrimtar para tij apo prej Shakespeare-it e më pas ka arritur të zotëroj si ai aftësinë e krijimit të thellësisë dhe larmisë së dritëhijeve të personazheve, pikëvështrime që tejkalojnë çdo lloj kontekstualizmi që u paracaktohet dramave. Johnson-i, duke e pikasur fort mirë këtë, na nxit ta lexojmë Shakespear-in që të na çlirojë nga "dalldisjet delirante. "Lejoëni ta shtjelloj më tej këshillën e Johnson-it i cili na nxit gjithashtu që të pranojmë djajtë që dëbon leximi i thellë i Shekspirit. Njëri sosh është Vdekja e Autorit; një tjetër është pohimi që vetvetja është trillim; dhe tjetri në radhë është ai sipas të cilit personazhet letrarë e dramatikë janë thjesht shenja të shumta të lëna në letër. Djalli i katërt dhe më I kobshmi është mendimi se gjuha është ajo që përcakton mendimin tonë.

Sërish, dashuria ime për Johnson-in, dhe për leximin, më shtyn të shmang polemikat, e në vend të tyre të lartësoj shumë prej lexuesve vetmitarë që takoj vazhdimisht, qoftë në auditore apo në letrat që më dërgojnë. Ne lexojmë Shekspirin, Danten, Chaucer-in, Servantesin, Dikensin, Prustin, dhe të gjithë të ngjashmit e tyre sepse ata i zgjerojnë përmasat e kuptimit të jetës. Praktikisht, ata përbëjnë Bekim, në kuptimin e vet më hyjnor me "më shumë jetë në një kohë që s'ka kufij." Ne lexojmë pafundësisht për shumë arsye, disa prej tyre të ditura: ngase s'mund ti njohim plotësisht njerëzit, t'i njohim aq sa të mos ketë më nevojë: ngase kemi nevojë të njohim më mirë veten; ngase kemi nevojë për dijen jo vetëm në lidhje me veten dhe të tjerët, por edhe se si janë punët e kësaj bote.

Prapseprapë, motivi më i fuqishëm dhe themelor për një lexim të thellë të veprave tradicionale klasike jo pak të nëpërkëmbura, është gjurmimi i ëndjes së mundimshme. Afërmendsh që nuk jam nxitës i leximeve erotike, por ëndja e mundishme mua më duket përkufizimi më i mirë i Madhështores në letërsi, edhe pse kjo ëndje e epërme mbetet kërkimi i pareshtur i lexuesit. Eziston pra, Madhështimi i lexuesit, dhe duket të jetë i vetmi tejkalim i kufijve normal të ekzistencës që mund të arrijmë ndonjëherë, me përjashtim të rastit më skajshëm që ne e quajmë "të rënit në dashuri." Ju bëj thirrje të lexoni çka i përshtatet shpirtit tuaj, çka i jep peshë mendimit dhe gjykimit. Lexoni thellësisht, jo për të besuar, as për të pranuar, as për të kundërshtuar, porse për të mësuar të njësoheni me atë natyrë si e juaja që edhe shkruan edhe lexon.

Përktheu: Granit Zela

VAJZA QË ÇLIROI POEZINË

nga Shqiptar Oseku

"Se ç'kish një gjah, një uri në zemër."

Sa libra të mirë duhen për të shkundur një letërsi të fjetur? Mjafton me pesë, do të përgjigjej Edith Södergran, suedeze etnike nga Finlanda, vajzë e talentuar që këndelli poezinë skandinave në fillim të shekullit njëzet. Se aq libra arriti të botonte ajo vetë: katër përmbledhje të holla poezish dhe një libër aforizmash, para se ta mirrte tuberkulozi në moshën 31 vjeç.

Mirëpo, ato pesë libra ndryshuan themelshëm mënyrën si shkruhej poezia në Skandinavi. Para tyre kish mbretëruar gjatë fryma e nacionalromantizmit. Vjersha me rimë, epose heronjsh të vërtetë a të trilluar, apoteoza zotërash vikingë mbi syprina akujsh. Mbretëria suedeze, dikur perandori e fuqishme, e cila u kish luajtur tokën Rusisë e principatave gjermane në shek XVII, ish dërmuar ushtarakisht, e ish skajuar në një qoshk të Skandinavisë. Dhe poezia e kish ndjekur nga pas shtetin e shkatërruar, si qen i lidhur pas qerres. Asaj i ish caktuar si detyrë të lehë kundër territ, të duket e fortë dhe e fisme, të fshehë fikjen e një aristokracie të shtjerrur.

Por pas përmbledhjeve nga Södergran, reliefi i poezisë suedeze s'njihej më: gjithçka kish ndryshuar nga pena e saj, si nga një orkan. Rima ish hedhur për dritare. Qendra ish okupuar nga individi. Rrezëllitja fallco e vjershërimit dekorativ ish zëvendësuar nga përroje të errëta ekzistenciale. Një vajzë e ardhur nga provincat jashtë Suedisë kish rrëzuar pothuaj filli vetëm një traditë letrare hijerëndë, duke çliruar poezinë nga burgu, e duke u hapur portat anembanë modernizmit, simbolizmit, ekspresionizmit, futurizmit.

Konteksti historik e social

Kritikët sot gjykojnmë se Edith Södergran ishte "heroinë që u mbart mbi supe nga një epokë e re, atje tek u thye epoka e vjetër". Privilegjet e aristokracisë po thërmoheshin, teknologjia moderne qe demokratike, e ideja e barazisë sociale e gjinore po përhapej si zjarr stepash edhe në letërsi. Gazeta të pavarura, shtypshkronja të palicencuara, shkrimtarë që botonin pa miratim nga oborri mbretnor. Koha ishte e arrirë për një Jean D'Arc të letërsisë. Dhe ajo nuk zhgënjeu.

Biografët e poetes Edith Södergran kërkojnë shpesh arsyet e madhështisë së saj në jetëshkrimin e parëndomtë. Edith lind më 1892 në një familje të shtresës së mesme në Petrograd të Rusisë, me të jatin Mats mekanik, e të ëmën Helena amvise me interes letrar. Çifti ka një shtëpi të veten, kjo quhet lluks në atë kohë. Por streha e tyre fsheh sekrete humbjesh e pësimesh. Për plakun Södergran, një alkoolist tuberkular, kjo është martesa e dytë, pas vdekjes së gruas së parë tok me dy fëmijë po nga tuberkulozi. Plaku do të rrijë përherë larg shtëpisë, prind biologjik veç për numër. E ëma Helena ka patur dikur një fëmijë jashtë martese, që ka vdekur foshnje nga tuberkulozi. Ajo gjen harresë dhe ngushëllim në lexim.

Nëna është lexuesja dhe kritikja e parë e vajzës së talentuar; citati që përshkruan njeriun Edith Södergran në krye të këtij shkrimi vjen nga Helena. Në të gjitha shkrimet nga Edith Södergran nuk gjindet pothuaj asnjë gjurmë e të jatit. Një biograf, Rahikainen (2015), shkruan se Edith Södergran ish rritur mes grash të forta nga ana e së ëmës. "Ky konstelacion familjar kish bërë që asaj t'i shkojë natyrshëm vendosja në qendër dhe vëmendja e publikut."

"Dua të vdes poete"

Talentet e vajzës Södergran pikasen herët. Që në klasë të parë ajo flet gjashtë gjuhë, gjermanisht si gjuhë të shkrimeve të hershme, por edhe rusisht e finlandisht si gjuhë komunikimi, frëngjisht e anglisht si gjuhë letrare, e suedisht si të folme shtëpie. Ky erudicion gjuhësor do të ndikojë më vonë edhe në poezinë e saj, në atmosferën kozmopolite, e në figurat e larmishme gjuhësore ku mpleksen kultura të ndryshme. Poezitë e para, të cilat Edith Södergran i boton në moshën 15 vjeç, paralajmërojnë madhështinë. Vajza Södergran adhuron asokohe idhullin Heinrich Heine dhe shkruan në gjermanisht. Por arrin megjithatë të sajojë një univers e ritëm vetjak, në një stil të lirë asociativ i cili, me kohën, do të bëhej emblem i saj.

Më 3 tetor 1908, kur Edith është 16 vjeç, befas resht së shkruari në gjermanisht. Ajo sa ka marrë vesh se është e prekur edhe vetë nga tuberkulozi, e se do të shtrihet në sanatoriumin ku ka ndenjur i jati. Në atë kohë, tuberkulozi është sëmundje e pashërueshme që korr 80 përqind të të prekurve. Ky është momenti i saj definues, takim i saj me historinë. Adoleshentja Edith Södergran merr vendim koshient që të vdesë si poete, e që medium të vetin kreativ do ta bëjë pikërisht suedishten e fëmijërisë, të cilën ajo e njeh më pak (!) nga gjithë gjuhët që përdor.

Edith është e elektrizuar nga ky vendim. "Unë lahem në elektricitet blu", i shkruan Edith shoqes së vet Hagar Olsson, shkrimtare, dramaturge, e kritike e letërsisë. Edith dhe Hagar ndajnë një afeksion të rrëmbyeshëm pasioni e xhelozie, por kjo s'e pengon Edith që t'i propozojë martesë një doktori në sanatorium. Vajza e re e shenjuar nga vdekja jeton çdo ditë si të ish e fundit, skandalet publike shkojnë rrëke.

Dhe ajo shkruan, shkruan, shkruan me zell delirant, aq magjishem e vrullshëm sa s'ish shkruar ndonjëherë në suedisht. "Unë jam shpatë", shkruan ajo në atë kohë, ndërsa tehu i saj i lë pa frymë lexuesit e revistave letrare të kohës. Përmbledhja e parë, me titullin e thjeshtë "Dikter" (shq. Vjersha) botohet më 1916 dhe shkakton një tërmet të vogël. Vajza 24 vjeç nga provinca guxon të shkruajë si nimfë sensuale, e t'i quajë burrat gdhë të pashpresë. Shumë syresh e quajnë banale, u pengon kjo që Edith s'u mbahet rimave, normave, pritshmërive. Strofa e fundit në këtë përmbledhje bën pjesë sot ndër vargjet më të cituarat në poezinë suedeze:

Ti lype lule
e gjete një frut.
Ti lype burim
e gjete një det.
Ti lype grua
e gjete një shpirt --
sa qenke zhgënjyer.

"Sakrifikoj çdo atom për të arritur cakun"

Më pak se një vit më vonë, në tetor 1917, ndodh puçi i përgjakshëm i bolshevikëve në Rusi, e tërë pasuria private e qytetarëve konfiskohet nga shteti. Nënë e bijë Södergran varfërohen brenda natës. Ato mbijetojnë duke shitur orendi të shtëpisë. Por Södergran vazhdon të shkruajë, si e pllakosur nga fuqi të mbinatyrshme. Rrëmuja përreth nuk i prek rrathët e zemrës. Ajo është e shkëputur, eksploron shqisat e ndjenjat, reflekton rreth natyrës së njeriut, e thirrjes së ekzistencës.

Përmbledhja e dytë, Septemberlyran (shq. përaf. Harpa e shtatorit) i botohet më 1918. Lexuesit e pamësuar dhe kritikët e shokuar reagojnë ndaj vetëbesimit të saj. Ajo s'i quan poezitë e veta "prova poezie", siç është e rëndomtë për gocat e sjellshme të kohës, s'u përket atyre që kërkojnë falje pse kanë talent. Edith Södergran, e cila tashti është fantaksur pas Nietzches, nis librin me një parafjalë të veten në formë të një manifesti rebel, i cili ngre shkumë debati. U bëre ti, thonë kritikët. S›i ka hije një pende të pasprovuar të krenohet në këtë mënyrë, aq më pak një pende vajze.

"Zjarri i brendshëm është gjëja më e çmuar e njeriut. Rruzulli tokësor u përket atyre që mbajnë brenda vetes muzikën më të lartë. Unë sakrifikoj çdo atom të forcës sime për të arritur cakun. Bëj jetë prej shenjtori, thellohem në arritjen e shpirtit të njeriut, u shmangem të gjitha ndikimeve të llojit të ulët... Ky libër imi s'ka shkuar kot nëse veç një individ e rrok madhështinë e këtij lloji të artit. Ndihem e bekuar që kam bërë këtë poezi; s'ka mënyrë për të shprehur falënderimin për shtëpinë botuese që e ka botuar. Një epokë e re ka arritur."

Përmbledhja e tretë, Rosenaltaret (shq. Altar trëndafilash), botohet më 1919, njëherësh me një libër aforizmash. Altar trëndafilash eksploron bukurinë e ekzistencës, e ndjenjën e të qenit e përzgjedhur, por këtu pikaset edhe një nënton më i errët. Të qenit e përzgjedhur është bekim, por edhe barrë e rëndë. Një cikël poezish i kushtohet në mënyrë diskrete të dashurës Hagar Olsson. Përmbledhja ka edhe një prekje spirituale, përmenden Zarathustra, Diana, Afrodita, Vishnu. Södergran, e cila në këtë kohë është thelluar ne psikologji e në mitologji, kërkon arketipe për të sajuar një arqitekturë universale të poezisë.

Feniksi i fundit

Vitet e fundit të jetës Edith Södergran janë të rënda. Tuberkulozi i shkakton gjakderdhje, e varfëria bëhet

ekstreme. Edith ka takuar një kompozitor e poet, Elmer Diktonius, suedez etnik nga Finlanda edhe ai, me të cilin shkëmben shkrime, e ndan atë lumturi të pikëllimtë që ndajnë çiftet para vdekjes së prerë. Ai është i magjepsur nga dhuntitë e saj.

"Ajo shkëlqen. Södergran. S'kam hasur njeri që buzëqesh si buzëqesh ajo. Mbinjeri aq i madh, në një njeri aq të vocërr".

Por dashuria gëlon nën hije të shpatës. Trevat ku ka lindur Edith Södergran janë në shënjestër të Rusisë dhe ajo sikur parandien fundin apokaliptik të gjithçkajes. Pak vjet pas vdekjes së saj, rusët pushtojnë grykën e Kareleve, dëbojnë popullsinë vendase, e hedhin në ajër tërë qytezën Raviola. Sot atje ku ishte qyteza ndodhet një pyll i egër, pa asnjë gjurmë që dëshmon se dikur aty kanë rrojtur njerëz. Kisha ku është varrosur Edith Södergran dhe varri i saj nuk gjenden dot, i humbur mes mështeknash, bredhash, e shkurresh me lule.

Përmbledhja e katërt dhe e fundit e poezisë, Framtidens skugga (shq. Hije e së ardhmes), u shkrua në vitet e fundit të qytezës Raviola, e u botua në Helsinki më 1920. Poezia lamtumirëse "Vendi që nuk është", e cila emërtoi antologjinë postume që u botua një vit pas vdekjes, më 1925, ndodhet tek kjo përmbledhje.

Hëna më rrëfen në hieroglife të argjendta
për vendin që nuk është...
Jeta ime paska qenë një dalldisje e valë.
Veç një gjë kam gjetur, e një gjë kam fituar njëmend-
rrugën për tek vendi që nuk është."

Përmbledhja Hije e së ardhmes i ngjan një feniksi që flakëron edhe një herë të fundit, para se të kthehet në hi. Këtu kulminon kushtrimi halucinant i vizioneve të Edith Södergran. Shkëlqimi kozmik i poezive premton një fillim të ri të botës, dikur matanë zezonave, shkatërrimeve, e vdekjes që ka pllakosur. Edith Södergran është frymëzuar nga antropozofët, tekstet ungjillore, e ato të misticistëve kristianë. Ajo vazhdon të shkruajë gjer në fund, ndërsa vdekja i invadon përdhunshëm cepat e qenies. Teksa shkruan vargjet e fundit ajo pështyn gjak, e ndien shpërthimet artilerike jashtë dritaresh. Finlanda ka shpallur pavarësinë dhe lufton për mbijetim.

I dashuri i saj, Elmer Diktonius, ndodhet në strehimore bombash në Helsinki kur lexon letrën lamtumirëse nga Edith Södergran.

"Mos më harro, ti murlan i fortë. Sa morra një kartolinë nga Hagar, fushat e narcisëve në Les Avants. Është çast shumë i rëndë për mua ky. S'duroj më ngacmim të dritës, as tinguj."

Trashëgimia

Si ndodh shpesh me artistë, poezia e shkruar nga Edith Södergran u çmua më fort pas vdekjes së saj. Ajo vdes në kremtën e mesverës, në vendlindjen Raviola. Ditëve të fundit ajo djeg një mal me poezi dhe letra private. Por e ëma gjen të harruar mes librash dy poezitë e fundit, "Hades" dhe "Vendi që nuk është". Të dyjat janë interpretuar si spirituale, si grahmë e fundit e një njeriu në prag të vdekjes. Vdekja e saj trondit miqtë e saj dhe të gjithë shkruajnë për të, duke ringjallur interesim te publiku.

"Brezi i ri i poetëve nordikë ka humbur burimin e vet. Bota ka humbur një nga gratë më krijuese të të gjitha kohërave. Finlanda ka humbur çfarë ka patur rrallë: një gjeni, një pishtar."

Sa dihet, kjo është hera e parë që fjala "gjeni", e cila rëndom është e ndarë veç për burra, përdoret në Skandinavi për një grua krijuese. Një emërtim krejt i saktë, po ta përdorësh kategorizimin e veprave letrare që ka bërë, ta zëme, albanologu dr. Ibrahim Rugova, ku "gjeniale" quhen veç veprat që ndryshojnë mënyrën si shkruhet letërsia. Kritikët e mëvonshëm skandinavë konfirmojnë madhështinë e saj:

"Ajo sajoi një gjuhë të re, një metagjuhë. Fjalët i ngjajnë suedishtes, por ngjashmëria është mashtruese. Më mirë ta marrësh si gjuhë eolike, ta zëmë, e t'i interpretosh me fjalor të tyre. Dhe fjalori është poezia e saj."

Tjerë kritikë fracezë, gjermanë, e anglosaksonë e kanë krahasuar ndër vite poeten Edith Södergran me emra si Emily Brontë, Arthur Rimbaud, Franz Kafka, Emily Dickinson a Sylvia Plath, gjithnjë duke theksuar origjinalitetin e gjuhës së saj. Edith Södergran bën pjesë sot në të gjitha tekstet e letërsisë suedeze që mësohet në shkolla, si dhe në të gjitha antologjitë e poezisë suedeze.

Edith Södergran është botuar postum pas vdekjes mbi njëzet herë, ndonëse tërë veprimtaria e saj mund të përmblidhet në më pak se 200 faqe. Kaq mjafton, pra, për të ndryshuar mënyrën si shkruhet letërsia. Kaq i mjaftoi vajzës së guximshme nga provinca e Kareleve, për të ndryshuar fytyrën e letërsisë në suedisht. 200 faqe, në pesë libra. Mjaftojnë sa të duash – nëse shkruhen nga dora e një gjeniu.

PASHË NJË PEMË *(1916)*

Pashë një pemë që ishte më e lartë se tjerat
tek varej përplot arra të paarritshme;
pashë një kishë me portat hapur
e të gjithë që dolën prej aty qenë të zbehtë e të fortë
e të gatshëm për të vdekur;
pashë një grua që e buzëqeshur dhe e grimosur
hodhi zaret për fat të vetin
e shikoi se humbi.

Një rreth ish tërhequr rreth këtyre gjërave
të cilin askush s'e kalon.

VIERGE MODERNE *(1916)*

Unë s'jam grua. Unë jam neutrum.
Jam një fëmijë, një shqytar e një vendim i guximshëm,
jam rreze e qeshur e një dielli të kuq flakë.
Jam rrjetë për peshq të uritur,
jam dolli për nder të gjitha grave,
jam hap drejt rastësisë e përmbysjes,
jam hop drejt lirisë e vetvetes.
Jam pëshpërima e gjakut në vesh të burrit,
jam dalldisje e shpirtit, mall e mohim i mishit,
jam tabelë orientimi drejt parajsash të reja.
Jam një flakë, kërkuese e ngacmuese,
jam ujë, i thellë e tundues gjer në gjunj,
jam zjarr e ujë në shoqërim të sinqertë me kushte të lira.

GRIMACE D'ARTISTE *(1918)*

Unë tjetër nuk kam pos pelerinës së dritës,
trimërisë sime të kuqe.
Trimëria ime e kuqe del për avantura
ndër troje të bjerra.

Unë tjetër nuk kam pos lyrës nën sqetull,
vegla ime me tela të sertë;
lyra ime e sertë i këndon mikut e armikut
në rrugë të madhe.

Unë tjetër nuk kam pos kurorës kyelartë,
krenarisë sime të ngritur.
Krenaria ime e ngritur vë lyrën në sqetull
e përkulet në lamtumirë.

VENDIM *(1920)*

Unë jam njeri shumë i arrirë,
por askush s'më njeh.
Miqtë kanë sajuar një imazh timin të rrejshëm.
Unë nuk jam e zbutur.
Unë kam peshuar butësinë në kthetra të mia prej shqiponje dhe e njoh fort mire.
Shqiponjë, ç'delir jep flatrimi i krahëve tu.
Do të heshtësh edhe ti, si gjithçka?
Do të shkruash ndoshta një poezi? Ti s'do të shkruash poezi më kurrë.
Çdo varg do të jetë shqyerje e një vargu,
jo poezi, po shenjë kthetrash.

NE GRATË *(1916)*

Ne gratë, ne jemi kaq afër tokës së murrme.
Pyesim qyqen se ç'pret nga pranvera,
marrim në grykë trungje të zhvoshkura,
kundrojmë në perëndim për shenja e këshilla.
Unë dashuroja dikur një burrë, i cili s'besonte
ne asgjë....
Ai erdhi një ditë me sytë bosh,
ai iku një ditë të rëndë me harresë mbi ball.
Nëse fëmija im s'jeton, i tij do të jetë.

DY RRUGË *(1917)*

Ti do të braktisësh rrugën tënde,
ajo është e pistë:
andej barisin burra shikimesh epshore
e fjalën: fat! e dëgjon nga gjitha buzët
e ca më poshtë në rrugë shtrihet kufoma e një gruaje
e copëtohet nga orlat.

Ti ke gjetur rrugën tënde të re,
ajo është e pastër:
andej enden fëmijë jetimë e lozin me bozhure,
andej enden gra në të zeza e përmendin pikëllime
e ca më poshtë në rrugë qëndron një shenjtore e zbehtë
me këmbën mbi qafë të kuçedrës së vrarë.

PISHTARËT *(1919)*

Dua të ndez pishtarët e mi mbi botën.
Flakadani im do të qëndrojë
në çdo çiflik nate
ndër alpe, ku ajri është bekim,
në tundra, ku qielli është melankoli.
O pishtari im, ndriçdo fytyrat e të tmerruarve,
të përloturve, të errësuarve, të ndoturve.
Një zot i butë ma zgjat dorën:
pa bukuri njeriu s'rron dot as një sekond.

NË DIVAN ME ZANAT *(1920)*

Natë e ditë
rri shtrirë në divan me zanat
e më kujtohen gjëra të habitshme.
Ajo zemër s'qenkesh lindur për të më dashur:
s'do të kalojë kurrë mbi prag realiteti.
Llamba e Dianës
ndriçon netët e mia
me tis të hollë përrallash.
Unë s'bën të dashuroj, s'e bëj tribut zemrën time.
Por një here do ta shtrij birin më të mire të tokës.
Një djalë të vogël
do ta mëkoj në gjirin tim prej guri
me tamblin më të fortë në botë.
Do ta quaj – shërbëtor të Dianës.

MUÇ XHEPA

NË SIRTAR

TREGIME